

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7476 E enjte 22 Mars 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* Ditës

Edi Rama ka treguar edhe njëherë në Bruksel se ai di të jetë një manipulues i talentuar. Në qëndrimet që ka mbajtur dhe në intervistat që ka dhënë, gjatë ...
Vijon në faqen 20

Nga ANDI BUSHATI

Fytyra e Ramës në pasqyrën e Brukselit



Dje në "Deutsche Welle"

Me 80 vota pro dhe me kundërshtimin dhe gazin lotsjellës të hedhur disa herë në seancat e mëparshme nga Lëvizja Vetëvendosja, Kuvendi ...
Vijon në faqen 21

Nga BEKIM SHEHU

Demarkacioni, një fitore e vështirë



Aktorët kundër kullave: Të mos bëhet me PPP

Artistët në unison kundër teatrit "Rama": Xhungël urbane

Robert Ndrenika: Më shqetëson partneriteti me privatën. Liçaj: Qeveria të silllet si e majtë

Projekti i arkitektit danez Bjarke Ingels për Teatrin e ri Kombëtar, që u prezantua nga kryeministri Rama, ka hasur në kundërshtimet e ashpra të komunitetit artistik. Projekti parashihet një godinë tri katesh me biznese brenda, që për t'u ndërtuar do t'i japë sipërmarrësve lejen për 6 kulla të larta afër saj. Ndonëse kryeministri tha se teatri ...
Në faqen 11

KRITERET DHE DOKUMENTACIONI QE DUHET TE PLOTESONI, SA ESHTË MASA QE MERRNI

PAGESA E PAPUNESISE, SA MUAJ PERFITOHET FALAS

Vendimi i ri i qeverisë: Si bazë merren kontributet e derdhura. Ndërprerja e të ardhurave, të gjitha rastet që mund t'ju penalizojnë



(Në foto) Zyra e punës

FLET KRYEMINISTRI

Rama: Basha nuk e mbajti fjalën, do të lobonim bashkë për çeljen e negociatave

Në faqen 3

KUNDËR PËRGJIGJET

Debati për kokainën, ministri: Basha dhe Berisha të sjellin prova. Akuzat konkrete

Në faqen 5

LISTA E PLOTE

ALUIZNI: 418 personat

që kanë gati lejet e legalizimit në qarkun e Fierit

Në faqen 6

KATEGORIZIMI

Subvencioni i shtetit, 626 milionë lekë për serra, ja si do ndahen fondet e bujqësisë

Në faqen 9

Ekskluzive / Zbulohet informacioni sekret i vitit 1973, i Ksenofon Dilos për Ramiz Alinë

"Bakalli, Gjergo, Velo, Oseku dhe Shima, me ndikime të huaja"

Hamid Beqja: "Shoku Ramiz, në dosje kemi riprodhime pikturash, t'ia japim edhe shokut Enver"

Nga DASHNOR KALOÇI

Ndër mbledhjet e shumta që u bënë në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të Tiranës në fillim e vitit 1973 pas fjalës së Enver Hoxhës e mbajtur më 15 e 16 mars në aparatën e Presidiumit të Kuvën-



dit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte "Lufta kundër shfaqjeve të huaja e liberale në art e kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vëndit...", edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe artistëve u mbajtën një sërë ...
Në faqet 12-13

MJEKESIA POPULLORE



Ylli Merja: Hithra, mbretëresha e bimëve mjekësore në Shqipëri, ja çfarë sëmundjesh lufton

Në faqen 15

INTEGRIMI TAKIMET

Presidenti dhe ministri i Jashtëm presin delegacionin e Këshillit të BE

Ilir Meta: Të hapen sa më parë negociatat, do vijojmë reformat

Ambasadorët me Bushatin: Të zgjidhen çështjet dypalëshe

Darina Tanushi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta kërkoj dje, nga vendet anëtare të Bashkimit Europian çeljen e negociatave për Shqipërinë. Kreu i shtetit priti dje, në një takim Komitetin e Çështjeve Politike dhe të Sigurisë së Këshillit të BE-së, të përbërë nga ambasadorët të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Presidenti Meta theksoi se politika e jashtme dhe e sigurisë së Shqipërisë është plotësisht e harmonizuar me Bashkimin Europian, dhe se e konsideron shumë të rëndësishëm bashkëpunimin operacional dhe strategjik ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në përballjen me sfidat dhe rreziqet e sigurisë. Presidenti Meta vuri në dukje rolin konstruktiv të Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit rajonal dy dhe shumëpalësh, duke çmuar se ky është një kontribut i drejtë-përdrejtë për të ardhmen evropiane të vendit dhe të gjithë rajonit. Presidenti i Republikës ripërsëriti kërkesën unanime në emër të të gjithë aktorëve institucionalë dhe politikë në vend drejtuar vendeve anëtare të Bashkimit Europian për hapjen sa më parë të negociatave të anëtarësimit, duke siguruar për vazhdimin e reformave në 5 prioritetet kyçe. Nga ana e tij, edhe ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, priti në një takim të veçantë anëtarët e Komitetit të Çështjeve Politike dhe të Sigurisë së Bashkimit Europian, të cilët janë për vizitë në Shqipëri. Ministri Bushati informoi dhe iu përgjigj pyetjeve dhe komentave të përfaqësuesve të vendeve anëtare të BE-së mbi aspektet kryesore të politikës së Jashtme të Shqipërisë, bashkëpunimin dhe kontributin e vendit në operacione civile dhe ushtarake të Bashkimit Europian, por edhe në NATO, mbi marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e ra-



Presidenti i Republikës, Ilir Meta në një takim Komitetin e Çështjeve Politike dhe të Sigurisë së Këshillit të BE-së

ANËTARËT E KËSHILLIT

Përfaqësuesit e vendeve anëtare vlerësuan ndër të tjera ecurinë e reformave si dhe kontributin e Shqipërisë në forcimin e bashkëpunimit rajonal. Ata nënvizuan rëndësinë e forcimit të perspektivës evropiane të rajonit të Ballkanit dhe vunë theksin në nevojën e zgjidhjes sa më parë të të gjitha mosmarrëveshjeve dypalëshe si kontribut i rëndësishëm në përshejtimin e procesit të integrimit evropian të të gjithë rajonit.

Lobimi do të vijojë në kryeqytetet kryesore të vendeve anëtare

Bushati nis turin në vendet e BE, sot takimet me zyrtarët gjermanë

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati nisi dje, turin në kryeqytetet kryesore të vendeve të Bashkimit Europian. Ai ndodhet për vizitë në Republikën Federale Gjermane, si pjesë e këtij turi. Gjatë vizitës në Republikën Federale Gjermane, ministri Bushati do të zhvillojë një takim me ministrin e Shtetit për Europën, Michael Roth, të cilin do ta njohë me progresin e vendit në fushën e reformave dhe adresimin e prioritetëve kryesore, pritishtë meritë tona në lidhje me avancimin e marrëdhënive të Shqipërisë me



Bashkimin Evropian, në drejtim të hapjes së negociatave si dhe do të shkëmbejnë mendime rreth situatës në rajon dhe Europë. Pjesë e rëndësishme e axhendës së ministrit Bushati, do të jenë

demokratike në vendin tonë dhe në procesin e integrimit evropian dhe evidentoi impaktin transformues që ka politika e zgjerimit në vendet e rajonit të Ballkanit. Ai theksoi rëndësinë e reformave në

fushën e drejtësisë dhe forcimit të shtetit ligjor në Shqipëri dhe lidhjen e drejtë-përdrejtë e ndikimit të tyre në sigurinë e vendit. Përfaqësuesit e vendeve anëtare vlerësuan ndër të tjera ecur-

inë e reformave si dhe kontributin e Shqipërisë në forcimin e bashkëpunimit rajonal. Ata nënvizuan rëndësinë e forcimit të perspektivës evropiane të rajonit të Ballkanit dhe vunë thek-



Kryeministri Edi Rama në Bruksel, me "Miqte" e Shqipërisë

PROJEKTLIGJI

Majko: Diaspora nuk do të trajtohet më si faktor i jashtëm nga shteti

"Me projektligjin 'Për diasporën', shteti shqiptar do të shkeputet nga marrëdhëniet formale të trajtimit të diasporës si një faktor i jashtëm", tha dje, ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko. Gjatë prezantimit të projektligjit "Për diasporën", në Komisionin për Politikën e Jashtme, Majko e cilësoi projektligjin "një moment evolutiv". Përpara fillimit të mbledhjes, kryetarja e komisionit, Mimi Kodheli tha se, "ligji vjen si një garanci e mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit, për promovimin e pjesëmarrjes së tyre më aktive në jetën e vendit të origjinës. Në fjalën e tij, ministri për Diasporën, Pandeli Majko tha se, "Ky ligj kuadër përfshin të gjitha problematikat dhe institucionet e interesuara që mbulojnë këtë fushë marrëdhënies nga ana e politikës shtetërore". Në këtë kontekst, Majko u shpreh se ligji mbështetet në kërkesat imediate për implementimin e plotë të dispozitave kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufijve". Gjithashtu, sipas tij, "projektligji është në harmoni dhe në frymën e standardeve ndërkombëtare të konsoliduar në një sërë aktesh, të tillë si, Karta e OKB-së, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Në raport me legjislacionin e zakonshëm, sipas ministrit, projektligji nuk krijon përplasje, pasi legjislacioni aktual ndjek të njëjtën frymë, por, në të njëjtën kohë, ky legjislacion dëshmon pamjaftueshmërinë për adresimin e plotë të nevojave të diasporës".



më parë të të gjitha mosmarrëveshjeve dypalëshe si kontribut i rëndësishëm në përshejtimin e procesit të integrimit evropian të të gjithë rajonit.



Kryeministri flet nga Brukseli: Serbia nuk hyn në BE para Shqipërisë

Rama: Basha nuk e mbajti fjalën, do lobonim bashkë për negociatat

"Mungesa e opozitës në këtë proces, për të ardhur keq"

Kryeministri Edi Rama ka zbuluar detaje nga takimi që pati afro një vit më parë me kreun e opozitës Lulzim Basha. Në një intervistë për RTSH gjatë qëndrimit të tij në Bruksel, Rama tha se Basha i kishte premtuar se do të ishin së bashku për të lobuar në çeljen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE. Por, tha ai, zoti Basha nuk e mbajti premtimin e tij ndërsa opozita po pengon ecurinë e këtij procesi për çeljen e negociatave mes Shqipërisë dhe BE gjatë presidencës së Bullgarisë. "Nuk po kërkojmë një favor, nuk po kërkojmë një dhuratë, nuk po kërkojmë një shprehje tjetër, përveçse afirmimit të asaj që meritojmë, hapjen e negociatave"-tha kryeministri Rama për RTSH pas takimit me grupin "Miqte e Shqipërisë" në Bruksel, me të cilët këmbënguli në mbështetjen e Shqipërisë për çeljen e bisedimeve me BE. "Shpresojmë dhe besojmë që Komisioni të jetë i drejtë me Shqipërinë dhe të bëjë një rekomandim të qartë dhe pastaj sigurisht mbetet bota diplomatike për të bindur çdo vend anëtar dhe për të bërë çmos që problematika të ndryshme, brenda vendeve të mos kthehen në një arsye që të penalizohet Shqipëria"-tha ai. Për kryeministrin shqiptar "Tanimë janë rezultatet që kanë filluar të flasin për reformën në drejtësi. 17 pesha të rënda të sistemit janë tërhequr vetë, nuk kanë shkuar në procesin e vettingut. Dëgjuesat, në dëgjimin e tyre, fillojnë këtë javë dhe të tjerë do të përballen me procesin e vettingut". Për zotin Rama "pastrimi i sistemit ka nisur". Lidhur me praninë në Bruksel të opozitës Rama tha se "Do të kishte qenë vërtetë e mrekullueshme që të ishim këtu së bashku me kryetarin e opozitës sikundër e patëm biseduar në mbremjen e gjatë të 17 majit, por për fat të keq kjo nuk ka ndodhur dhe do të na duhet që boshllëkun e madh që ka krijuar opozita dhe posaçërisht PD në këtë proces, ta mbushim me forcat tona", tha me ironi ai. "Nuk dua të bëj komente për opozitën. Opozita zgjedh dhe vendos atë që sheh më të arsyeshme. Populli sheh dhe gjykon, përfshirë dhe votuesit e opozitës, por dua të them që mungesa e opozitës në këtë proces apo disa deklaratat e llojit "më ka çuar nana me



Kryeministri Edi Rama

DEKLARATA
"Duke qenë se mbrojtja dhe siguria është shumë e rëndësishme, Europa ka nevojë për Ballkanin. Kjo është më se e qartë. Kriza e fundit e refugjatëve e ka treguar këtë hapur. Korridori i Ballkanit ishte themelor. Imagjinoni sikur vendet e Ballkanit nuk janë një kënd lojërash të Europës, por i përkasin të tjerëve, të kujtudo qofshin",-tha Rama.

la gojën", janë vërtetë për të ardhur keq"-tha zoti Rama. **SERBIA**
Në kohë, në një intervistë për POLITICO, kryeministri Rama tha se Serbia nuk do të hyjë në Bashkimin Europian përpara Shqipërisë megjithëse Beogradit është caktuar në pararojë të garës për anëtarësim. "Ne besojmë fort se raporti i Komisionit do të jetë pozitiv"-i tha PO-

LITICO-s Rama, gjatë një vizite në Bruksel për të shprehur përparësi të vendit të tij. "Për Këshillin, kjo është një luftë deri në sekondën e fundit, sepse na duhet t'i bindim të gjithë se ka vetëm një gjë të drejtë për të bërë." "Serbia nuk do të bëhet anëtare e BE-së përpara Shqipërisë. Kjo është diçka që e dimë me siguri," tha ai. "Serbia duhet të kalojë nëpërmjet procesit të

dhimbshtëm të njohjes së Kosovës apo të paktën (të zgjidhë) problemin e Kosovës"-tha Rama. "Besoj fort se duhet të ndodhë ndonjë magji, që nuk do të ndodhë, në mënyrë që ata të hyjnë në BE përpara nesh." "Ne kemi bërë pikërisht atë që na është kërkuar kështu që, ky proces duhet të jetë i drejtë dhe i parashikueshëm dhe duhet të bazohet në meritat",-tha Rama.

Knut Fleckenstein: Balanca e Shqipërisë pozitive, ka shanse

Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Europian, Knut Fleckenstein u shpreh dje, optimist për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë me Bashkimin Europian. Gjatë një interviste për TV Klan, Fleckenstein tha se Parlamenti Europian e mbështet avancimin e Shqipërisë në procesin e integritimit. "Ne në Parlamentin Europian do të japim rekomandimin tonë dhe në fund shtetet anëtare do të vendosin në gjirin e Këshillit të Ministrave. Por këtë radhë kam një parandjenjë të mirë, që ka një shans që vendimi të merret",-tha ai. Fleckenstein theksoi se nuk ka asnjë vend anëtar që të jetë shprehur në parim kundër nisjes së negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë, por gjatë kësaj kohe do të verifikohet ecuria e reformave. "Nuk ka kundërshtim në parim për hapjen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Ka disa pyetje lidhur me atë se si po vijohet me krimin e organizuar, si po shkon procesi i vettingut. Mendoj, se balanca e Shqipërisë është goxha pozitive dhe ne mund t'ia paraqesim këtë tablo shteteve anëtare që kërkojnë më shumë shpjegime",-u shpreh raporteri për Shqipërinë. Me 17 prill, Komisioni Europian do të publikojë një progresraport për këtë çështje. Në qendër të vëmendjes është ecuria e procesit të vettingut dhe reforma në drejtësi.

Vasili: Kryeministri luan valle çingjesh në Bruksel

Kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili u shpreh dje, se "Kryeministri u lodh duke luajtur valle çingjesh në Bruksel. E bëri copë-copë ligjin e shërbimit civil për të futur në punë ca hijër dhe ju kundërvu Brukselit". Sipas tij, "mijëra shqiptarë emigrojnë për shkak të varfërisë që prodhoi kryeministri, emigrojnë tragjikisht edhe mijëra fëmijë nga 7 deri në 17 vjeç. Ekonominë e shkatërroi me koncesione dhe korrupsion duke i dalë kundër edhe FMN. Droga është ulur këmbëkryq edhe në shkollat e fëmijëve dhe po rrënon edhe kursin e euros. Çfarë i kërkon opozitës për çeljen e negociatave në BE ky kryeministër?!". Vasili tha më tej se "fajtori i vetëm për vështirësitë në këtë proces të integritimit europian është ky kryeministër. Skepticizmi i europianëve vjen për shkak të rezultateve shkatërrimtare dhe imazhit të rrënuar të vendit që krijoi ky kryeministër fjalëshumë e punëshapak". "Brukseli dhe vendet anëtare presin rezultate dhe jo përdredhje çingjesh e qurravite qaramane të një kryeministri që për fat të keq nuk e do vendin e tij",-u shpreh Vasili, në një status në rrjetin social, "FB".

Pristinë, mbledhen kryetarët e parlamenteve të Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë

Thirrja e Ruçit: Të europeanizojmë Ballkanin, për integrimin e 3 vendeve

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë Gramoz Ruçi mori pjesë dje, në Forumin e Kryetarëve të Parlamenteve të Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë i organizuar në Prishtinë. Në këtë forum, krahas Kryetarit të Parlamentit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferri, merrnin pjesë edhe Ali Aliu, guhëtar dhe anëtar i Akademisë së Shkencave të Kosovës dhe anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe Arteve në Maqedoni dhe në Shqipëri dhe Hilmi Jashari, Avokati i Popullit në Kosovë. Ruçi i bëri thirrje politikës ballkanase që të integrohet në Bashkimin Europian duke europeanizuar Ballkanin dhe jo duke ballkanizuar Evropën. Kryetari i Kuvendit të Sh-



qipërisë dënoi aktet e dhunës në Kuvendin e Kosovës në seancën e diskutimit mbi ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit me Malin e Zi, duke thënë se dhuna nuk është mjet demokratik dhe ligjor i të shprehurit në Kuvend, në temullin e demokracisë. Lidhur me situatën politike në Maqedoni, Ruçi vlerësoi

bashkimin e spektrit politik shqiptar në Maqedoni duke shprehur se duhet të vijoi bashkëpunimi për integrimin e mëtejshëm të shtetit maqedonas në Bashkimin Europian dhe në NATO. I pyetur për faktorit shqiptar në Maqedoni, Ruçi pohoi efektin pozitiv që solli ky takim në bashkimin e partive shqiptare në Maqedoni drejt objektivave të përbashkëta. Ruçi u ndal edhe në sfidat që hasin të tre vendet duke shtuar se parlamentet respektive duhet të vijojnë punën e tyre për reformimin e kuadrove ligjore në mënyrë që të tre vendet, Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia të vijojnë rrugëtimin e tyre për anëtarësim të plotë në strukturat euro-atlantike.

**LOBIMI
DEBATI**

Hetimi i lobimeve, palët nuk bien dakord, Balla: Prokuroria të pyesë Bashën

Bylykbashi: Financimi më i madh i Tahirit, Fino: U ktheve nga Rusia

Shtyhet votimi i rezolutës për Komisionin Zgjedhor

Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është shijetuar nga sulmet politike, duke e akuzuar për mosveprimin e tij për të hetuar kontratat e lobimit të Partisë Demokratike. Për Taulant Ballën, KQZ dëshito të verifikojë kontratat e PD-së, dhe i vetmi organ që mund të hetojë është prokuroria. "Ka dyshime se 'çadra' e PD-së u financua për tre muaj nga rusët", tha Balla. Sipas tij, KQZ dëshito ndaj prokuroria duhet të pyesë urgjent Bashën për lobimin rus. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka dështuar të bëjë hetim për këto financime. Prokuroria duhet të veprojë menjëherë me Luzlim Bashën, sepse është firma e tij, e jo të fshihet pas Ristanit. Së shpejti do të kemi ndryshime ligjore për transparencën e financimeve të partive. Ka dyshime se edhe 'çadra' tre mujore e PD u financua nga të njëjtat burime", deklaroi z.Balla. Debat për veprimtarinë e KQZ-së pati dje edhe në Komisionin e Ligjeve, ku u diskutua rezoluta e Kuvendit për këtë institucion. PS kërkoi që KQZ të hetojë kontratat, ndërsa PD deklaroi se KQZ duhet të ketë prioritet trajtimin e shitblerjes së votës. Socialisti Alket Hyseni deklaroi: "KQZ duhet të thellojë verifikimin e kontratave të huaja, për sa kohë nga agjenci të huaja me funksion verifikimi janë bërë publike kontrata të reja të cilat nuk janë hetuar më parë nga KQZ". Ndërsa demokrat Oerd Bylykbashi reagoi duke thënë se "Prioriteti numër një i OSBE-ODIHR-it është shitblerja e votës. Ky fenomen duhet vendosur në krye të detyrave që ne i vendosim KQZ. Kompania ruse e nafës Gunvor ka derë të hapur për qeverinë, pyesni Ramën dhe Gjokunurin. Nuk ka deklarim financiar më të madh se ai i Habilajve për ish-ministrin e Brendshëm", deklaroi deputeti i PD-së, Bylykbashi. Por socialisti Bash-

kim Fino ironizoi: "Lëri këto, sa u ktheve nga Rusia...". Rezoluta për detyrat e KQZ-së nuk u miratua pasi PS dhe PD u angazhuan të gjejnë një

variant konsensual. Dy ditë më parë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve publikoi raportin financiar të Partisë Demokratike për vitin 2017,

ku detajohen në zëra të ardhurat dhe shpenzimet e forcës kryesore në opozitë për aktivitetet normale dhe ato elektorale.



Komisioni i Ligjeve

LOBIMI RUS, DEBATI NË KOMISIONIN E LIGJEVE

ALKET HYSENI: KQZ të verifikojë financimin e kundërligjshëm të partive. KQZ të thellojë verifikimin e financimeve të huaja dhe kontratat që janë bërë publike nga agjenci të huaja.
OERD BYLYKBASHI: Nuk mund t'i japim KQZ detyra mbi ligjin
FATMIR MEDIU: Të përfshihen blerja e votës, intimidimi i votuesve dhe përdorimi i resurseve shtetërore në fushatën zgjedhore.
OERD BYLYKBASHI: Nuk ka deklarim financiar më të madh se ai i Habilajve për ish-ministrin e Brendshëm
BASHKIM FINO: Lëri këto, sa u ktheve nga Rusia...
OERD BYLYKBASHI: Kompania ruse e nafës Gunvor ka derë të hapur në qeverinë tonë. Pyesni kryeministrin dhe Gjokunurin.
BLEDI ÇUÇI: Shitblerja e votës është problem shqiptar që duhet ta adresojmë të gjithë.

"Komisioni të trajtojë shitblerjen e votës"

"Zgjedhja", Borchard: Nga blerja e votës u cënoa besimi

Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Bernd Borchard theksoi dje domosdoshmërinë për të adresuar çështjen e blerjes së votës, duke nënvizuar nevojën për një reformë të plotë dhe në kohë që të trajtojë rekomandimet e ODIHR-t dhe çështje të tjera kyçe. "Sikurse u theksua nga ODIHR-i në raportin e 2017-s, Komisioni duhet t'i japë përparësi punës për të adresuar çështjet e vazhdueshme të blerjes së votës. Akuzat e shumta për blerje vote kanë cënuar besimin e publikut dhe nevojitet vullnet politik për t'iu kundërvënë këtij fenomeni. Ne po u kushtojmë vëmendje të veçantë rasteve të shkeljeve zgjedhore të denoncuar në prokurori. Tri çështjet që kanë shkuar në gjykatë deri tani janë një fillim, por vetëm një fillim", deklaroi z. Borchardt. Lidhur me teknologjitë e reja të votimit, Borchardt tha se praktikant më të mira



trajtojnë se vendimet për përdorimin e teknologjive të reja nuk duhet të vihen menjëherë në zbatim në zgjedhje. Sa i përket çështjes së votimit të shtetasve shqiptarë jashtë vendit, Borchardt tha se sfida është e madhe për të gjetur balancën ndërmjet sigurimit të të drejtës së votës për shtetasit që jetojnë jashtë Shqipërisë dhe garantimit të paprekshmërisë dhe sigurtisë së votës. Borchardt përsëriti gatishmërinë e Prezencës së OSBE-së për të

AKUZAT

"Akuzat e shumta për blerje vote kanë cënuar besimin e publikut dhe nevojitet vullnet politik për t'iu kundërvënë këtij fenomeni. Ne po u kushtojmë vëmendje të veçantë rasteve të shkeljeve zgjedhore të denoncuar në prokurori. Tri çështjet që kanë shkuar në gjykatë deri tani janë një fillim, por vetëm një fillim", tha z. Borchardt.

mbështetur reformën zgjedhore, së bashku me ODIHR-in dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Deklaratave të tij u bënë gjatë një takimi të organizuar nga Prezencia e OSBE-së me bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, Bledar Çuçi dhe Oerd Bylykbashi, njihohet përfaqëuesit e komunitetit ndërkombëtar me ecurinë e reformës zgjedhore, si dhe u përgjigjen pyetjeve të tyre.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

EDMOND SPAHO

Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së, Edmond Spaho, akuzoi dje ministrin e Financave, Arben Ahmetaj, lidhur me raportin e FMN-së. Ai shprehet se korrupsioni në ndërtimin e tre inceneratorëve është vetëm hapi i parë i skemës mafioze. Ndërtimi i 3 inceneratorëve është skema mafioze për t'i dhënë 178 milionë euro një personi të vetëm, të lidhur me Arben Ahmetajn", -tha Spaho.

Salianji, në PD vendos baza, jo inatet personale

Deputeti demokrat Ervin Salianji shprehu dje bindjen se përçarja e PD-së ka ardhur për shkak të interesave personale të anëtarëve të saj. Deputeti demokrat nënvizoi se Luzlim Basha është kryetar i partisë i zgjedhur nga shumica e votave dhe se të gjithë duhet të ndjekin vendimet e tij. "Ai është votuar nga thuhetse 60 000-70 000 demokratë. Vendimmarrjen për kryetarin e partisë e bën anëtarësia. Secili nga ne, që jemi në pozicione drejtuese apo ata që kanë qenë në pozicione drejtuese, mund të kemi pëlqyeshmeri personale, inate personale, tha Salianji për Ora News. Strukturat partiake e politike në përgjithësi funksionojnë që kur vendos baza, masa e madhe e anëtarësisë të ndjekë kryetarin e partisë. Nuk kam parë ndonjë organizatë, ku brenda organizatës një pjesë kërkojnë të rrezojnë publikisht drejtuesin e organizatës që të vijmë vetë. Çështjet personale janë një gjë dhe çështjet e të mirës në tërësi janë një gjë tjetër. Në mendimin tim personal janë pakënaqësi personale, tha ai. Mendoj, mendoja dhe do mendoj prap se kushdo që ka qenë në pozicion drejtues në kohën kur Partia Demokratike ka qeverisur, duhet të jetë më i përlulur dhe duhet t'iu kthejë qindra-mijëra demokratëve atë që kanë marrë nga kontributi i tyre."



Permbuesi i gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shiti ne ankand pasurine :

* "Pembore+Truali+Ndertesë me sip totale 620m2, nga e cila 200m2është truall dhe 90 m2 është ndertesë, me Numër pasurite 430/17, e ndodhur në Zonën Kadastrele 1100, e regjistruar në regjistrin hipotekore volum 6, faqe 227, me adresë në Fshatin Starbullsh Shkoder
2. Çmimi më të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërshkruar, është në vlerën 1.568.000 (njemilione e pesëqind e gjashtëdhjetëtelete mije) Lekë.

Shitja e pasurisë do të behet (zhvillohet) me date 26.03.2018 ora 16.16 në Zyren e permbuesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen para fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Banken BKT dega Shkoder me nr foligjate 41064051.



"Kanë dijeni për poseduesit e kokainës", ministri: Basha dhe Berisha të paraqesin provat

Basha i përgjigjet Xhafajt: Gjurmë Olsi Ramën dhe Agron Xhafën

"Akti i dënueshëm, po vendos prokurorinë nën tutelë"

Valentina Madani

Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj i kërkoi dje drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Besim Hajdarmataj, të thërrasë kreun e PD-së Basha dhe ish-kryeministrin Berisha, si persona që kanë dijeni lidhur me poseduesit e ngarkesës prej 613 kg kokainë në Durrës. Ministri i drejtohet z.Hajdarmataj përmes një letre në të cilën i shkruan: "Dy deputetët duhen thirrur pasi kanë bërë deklaratat publike se kanë dijeni se kush e zhvillon trafikun e drogës në vend dhe veçanërisht për faktet që kanë të bëjnë me poseduesit dhe përfituesit e sasisë prej 613 kg kokainë". Në shkresën e drejtuar Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ministri Xhafaj thekson se "nga këto deklarime publike bie veçanërisht në sy fakti se nga z.Sali Berisha dhe z.Basha pretendohet qartë që ata kanë dijeni për fakte konkrete lidhur me klanet e trafikut të drogës në Shqipëri. Po sipas këtyre deklaratimeve publike, rezultojnë se të dy këta persona kanë veçanërisht dijeni mbi poseduesit dhe përfituesit e sasisë prej 613 kilogramë kokainë të sekuestruar së fundmi në Portin e Durrësit". "Çmuj se ka interes të ligjshëm publik dhe posaçërisht për hetimin që është duke u kryer që, nga ana e institucionit që ju drejtoni, të thirren këta persona dhe të deklarohen përpara Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, faktet për të cilat kanë dijeni dhe provat, që ata zotërojnë për klanet kriminale të trafikut të drogës, përfshi edhe rastin e fundit të sekuestrimit të 613 kilogramë kokainë", -thuhet në letër. Ministri i Brendshëm nënvizon se është detyrim kushtetues i Berishës dhe Bashës t'i paraqesin Prokurorisë së Krimeve të Rënda faktet dhe provat që disponojnë. Kreu i PD-së Lulzim Basha i dha përgjigje ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj pas letrës së këtij të fundit për Prokurorinë e Krimeve të Rënda, që të marrë dëshminë e tij dhe të ish-kryeministrin Sali Berisha. Kreu i PD-së u pyet nëse



FATMIR XHAFAJ

"Dy deputetët duhen thirrur pasi kanë bërë deklaratat publike se kanë dijeni se kush e zhvillon trafikun e drogës në vend dhe veçanërisht për faktet që kanë të bëjnë me poseduesit dhe përfituesit e sasisë prej 613 kg kokainë", -tha z.Xhafaj. Sipas tij Basha dhe Berisha e kanë detyrim kushtetues që të paraqesin provat.

LULZIM BASHA

"Kjo deklaratë, letër është një akt i dënueshëm i Xhafajt, është vendosja de jure e prokurorisë nën tutelën e qeverisë. Informacioni më i sigurtë është prokuroria. Të hetojë dhe gjenden gjurmët e kokainës. Informacioni i dukshëm që mund të jap unë është që prokuroria të gjurmtojë Olsi dhe Edi Ramën", -tha z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Raporti i FMN, Basha: Kambanë alarmi, Ahmetaj: Lexoni si analfabetë

Kreu i PD-së, Lulzim Basha e cilësoi raportin e FMN-së një kambanë alarmi për ekonominë shqiptare. Sipas tij, FMN-ja ngriti shqetësimin e borxhit publik, që sipas Bashës shkon deri në 82% të PBB, pra në nivele alarmante, siç tha ai. Po ashtu Basha theksoi se Rama ishte marrë peng nga PPP-të, nuk janë gjë tjetër veçse forma të pastrimit të parave. Por ministri i Financave, Arben Ahmetaj u kundërpërgjigj: "Raporti i FMN është shumë serioz për një qenie kaq jo-serioze sa c'është opozita sot. Po që kryetari i opozitës ta lexojë publikisht raportin e FMN-së, si një analfabet që nuk ndjek dot as fillin e abetares, kjo shkon përtej Lulzimit si simbol paafëties individuale e budallallëku politik dhe rëndon qenësishet vetë institucionin e opozitës! Dhe ky është tanimë një problem i madh shoqëror, jo thjesht një boshllëk i madh politik në shoqëri".

NJOFTIM

Studio Përmbarrimore Zyber SHEHU zhvillon ankandin e II(Dytë) për pasurinë:
a. Pasuria Nr.2/32+1-9/1, vol.6, faqe 183, Z.K.8514, e apartament me sipërfaqe totale 70,13m2, e ndodhur në Durrës, çmimi 27.490,4 Euro.

Ankandi zhvillohet në datë 26.03.2018 në ambientet e Studios Përmbarrimore Zyber SHEHU me adresë: Pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Cel.0682089339, osë adresën e-mail: shehuzyber@yahoo.com

"Rama riktheu në punë kushërirën e Bares"

Ambasadori Lu i shkon në zyrë Berishës, ja për çfarë biseduan

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Donald Lu takoi dje ish-kryeministrin Sali Berisha. Lajmi u konfirmua nga zyra e Berishës, ku thuhet se ish-kryeministri priti në një takim në zyrën e tij ambasadorin amerikan, zotin Donald Lu. Nuk ka shumë të dhëna për temën e diskutimeve, por bëhet e ditur se janë prekur një spektër i gjerë çështjesh me interes të dyanshëm dhe se diskutimet ishin të hapura. "Diskutimet ishin të hapura!", thuhet në njoftim. Po dje ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje denoncimin e një qytetari dikhital sipas të cilit në krye të Spitalit të Vlorës kryeministri Rama, riktheu si drejtor Bruna Mersinin. Sipas denoncimit, "e proceduar nga kontrolli i shtetit pa dëshmi penaliteti sot u rikthye në krye të spitalit nga kriminelin Aldo Bare të cilin e ka djalë teze". "Për Ed-



Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Donald Lu dhe ish-kryeministrin Sali Berisha

vinin korrupsioni është meritë! E largojnë nga detyra për korrupsion, e rikthejnë po aty me rryshfet!", shprehet z.Berisha. "Po ju vë në dijeni dhe dua që këtë fakt ta bëni publik në parlamentin shqiptar dhe në të gjitha institucionet. Në krye të spitalit të Vlorës kryeministri Rama, riktheu si drejtor Bruna Mersinin. Sipas denoncimit, "e proceduar nga kontrolli i shtetit pa dëshmi penaliteti sot u rikthye në krye të spitalit nga kriminelin Aldo Bare të cilin e ka djalë teze". "Për Ed-

e bëra me popullin. E proceduar nga kontrolli i shtetit pa dëshmi penaliteti sot u rikthye në krye të spitalit nga kriminelin Aldo Bare, të cilin e ka djalë tezeje. Vetëm nga presioni i kriminelit Aldo Bare ajo u rikthye përsëri në krye të spitalit në konkurse të tipit Rama, ku konkursi u bë vetëm me Bruna Mersinin. Ju lutem, denoncojeni këtë fakt të paprecedent në administratën shqiptare. Ju lutem, verifikoheni problem-in për vërtetësinë e ankesave të mia", -thuhet në mesazhin e qytetarit dikhital.

do të ishte në gjendje të shkonte në prokurori, ai u përgjigj që ministri Xhafaj po përpigje ta vendoste prokurorinë nën pushtetin e tij, dhe që mjaftonte të gjurmohet Olsi Rama dhe Agron

Xhafa për të vërtetën e drogës së Maminasit. "Kjo deklaratë, letër është një akt i dënueshëm i Fatmir Xhafajt, është vendosja de jure e prokurorisë nën tutelën e qeverisë. Informacioni më i

sigurtë është prokuroria. Të hetojë dhe gjenden gjurmët e kokainës. Informacioni i dukshëm që mund të jap unë është që prokuroria të gjurmtojë Olsi dhe Edi Ramën", -tha Basha.

Legalizimet, përfutuesit të paraqiten për të tërhequr lejen

ALUIZNI: 418 personat që kanë gari lejen e legalizimit



Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 418 perso na që kanë ndërta- ar pa leje dhe pasi u është miratuar leja e legalizimit. Përfutuesit janë në qarkun e Fierit. Procedurat për marrjen e tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzoi dosjen e plotë në Hipotekë. Pas regjistrimit të lejes së legalizimit, prona- ri pajiset me certifikatë pronësie, për të cilën du-

Lista me pronarët në qarkun e Fierit

het të shkojë në Zyren e Regjistrimit të Pasurive për ta tërhequr. Pas ndryshimeve të fundit ligjore qytetari do të marrë një kopje të lejes së legalizimit për të vërtetuar mbarimin e procesit të legalizimit, por gjithë procedura vijuese për regjistrimin në

Zyren e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës, për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë, nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndër-

timet pa leje me funksion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat, për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së

pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve

takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

LISTA E PERSONAVE QE KANE LJET E LEGALIZIMIT GATI NE QARKUN FIER

Table with 2 columns: NR. EMER and LISTA E PERSONAVE QE KANE LJET E LEGALIZIMIT GATI NE QARKUN FIER. The table lists names and identification numbers for 418 individuals in Fier.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 4,671,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktëshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë BIC: STANALTR IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Mirëmbajtja vjetore e sistemit Cisco Web Content"

Oferta duhet të paraqitet në zyren e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 11 Prill 2018, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Avokati Ardian Visha: Burimi i pasurisë është motra e tij, Drita Lulo

Nis vetingu i gjyqtarëve, KPK: Fatos Lulo nuk justifikon pasurinë

"Anëtari i Gjykatës Kushtetuese ka përfituar 200 mijë USD"

Komisioni i pavarur i kualifikimit ka zhvilluar ditën e djeshme seancën e parë të vetingut. Gjyqtari i parë që u thirr përpara komisionit për t'u dëgjuar, ishte Fatos Lulo, anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Lulo, i cili nuk ishte i pranishëm në seancë, u përfaqësua nga avokati mbrojtës Ardian Visha. Gjatë seancës janë nxjerrë pretendime se në bazë të një hetimi administrativ 5-mujor ndaj Fatos Lulos, ky i fundit nuk justifikon me burime të ligjshme pasurinë e tij. Duke cituar raportin e përcjellë në KPK nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë, relatorja Etleda Çiftja tha se për subjektin e rivlerësimit Fatos Lulo ka mungesë të buri-me financiare të ligjshme dhe deklarim të rremë të pasurisë.

Gjithashtu, KPK thotë se gjyqtari ka përfituar 200 mijë dollarë dhuratë nga motra, Drita Lulo, konkretisht 100 mijë dollarë cash dhe një zyrë në rrugën e Durrësit për zotën Lulo. Në lidhje me këtë fakt, avokati i gjyqtarit, Ardian Visha, është shprehur se burimi i pasurisë së klientit të tij është e motra, Drita Lulo, e cila i ka dhuruar shuma parash dhe apartamente, si dhe shumën prej 480 mijë dollarë kanadez, të cilën gjyqtari ia ka marrë hua dhe ia ka kthyer sërish. Më tej avokati theksoi se Lulo në vitin 1997 i ka dhuruar motrës së tij biznesmene apartamentin e prindërve. Më pas motra që është ndërtesa e ka dhënë 100 mijë dollarë për shkollimin e fëmijëve dhe zyrën për punën e tij që llogaritet me vlerë 100 mijë dollarë. Ndërkohë sipas KPK Lulo ka shmangur pagesën e taksave në vitet '94-'97, kohë kur ishte avokat. Nga ana tjetër avokati Ardian Visha thotë se klienti i tij disponon librezën ku provon se ka paguar taksat. "Për periudhën e viteve '90, kur ishte avokat, është e padrejtë të gjykojmë të ardhurat kur zyra e Tati-meve nuk ka të dhënat. Për këtë ILDKP nuk mundet dot të pretendojë se nuk ka burim të ardhurash. Pasuritë e paluajshmë të Lulos janë shtëpia ku banon dhe një zyrë. Është tërësisht një ide biznesi e tij e paralelizuar pasuria 480 mijë dollarë në Kanada. ILDKP e kontrollon prej 15 vitesh Lulon dhe nuk gjen asgjë. Ka përpjekje për të çvarrosur kufoma, për të bërë një gjë të pabërë. Kjo është e pal-



Fatos Lulo, anëtar i Gjykatës Kushtetuese



Komisioni i pavarur i kualifikimit

480

MIJË DOLLARE KANADEZ

Ardian Visha, avokati i gjyqtarit Fatos Lulo, është shprehur se burimi i pasurisë së klientit të tij është e motra, Drita Lulo. Ai theksoi se Lulo në vitin 1997 i ka dhuruar motrës së tij biznesmene apartamentin e prindërve. Më pas motra që është ndërtesa e ka dhënë 100 mijë dollarë për shkollimin e fëmijëve dhe zyrën për punën e tij që llogaritet me vlerë 100 mijë dollarë. Për sa i përket shumës së përfolur prej 480 mijë dollarë kanadez, gjyqtari ia ka marrë hua të motrës dhe ia ka kthyer sërish.

ogjikshme për mua. Ka mungesë provash. Paraqita një sërë provash të reja, akte të reja që u pranuan nga trupa

gjykuese, që provojnë të ardhurat e motrës së Lulos. Drita Lulo ushtron disa aktivitete, ka përfituar për sh-

kak të marrëdhënies me një firmë", deklaroi Visha. Sakaq provat e reja u administruan nga Komisioni i Pavarur

i Kualifikimit, i cili pas shqyrtimit të tyre do ta bëjë publik vendimin e tij të premtën e 23 marsit.

SHKURT

Vrasja e efektivit në Lazarat, gjykata lë në burg përjetë Arbjon Alikon dhe Bajram Bocin

Gjykata e Krimeve të rënda ka zhvilluar ditën e djeshme seancën gjyqësore ndaj grupit të Lazaratit, të cilët akuzohen për vrasjen e efektivit Ibrahim Basha në qershor të vitit 2015. Krimet e Rënda dënuan me burgim të përjetshëm Arbjon Alikon dhe Bajram Bocin. Ndërkohë Alban Aliko, vëllai i Arbjon Alikos, është dënuar me 20 vite burg. Ndërsa Elvis Boci u dënua me 35 vite burg. Ndërkohë, me 18 vite burg është dënuar Elson Kasma, me 15 vite burg janë dënuar Dervish Gaba, Ruhani Hija dhe Iljaz Xhaferaj; me 13 vite burg Klodian Selimi, 10 vite burg Xhulio Malo dhe Oltion Proko i dënuar me 10 vite. I pandehuri Arbjon Aliko dyshohej si organizator i grupit të zjarrit në Lazarat, kur mbeti i vrarë efektivit i RENEAS, Ibrahim Basha. Ai dhe vëllai i tij Alban Aliko u arrestuan nga policia më 27 qershor 2015, disa ditë pas vrasjes së efektivit Basha.

Qëlluan me armë zjarri mbi policinë, 2 në kërkim

FIER - Dy persona nga Fieri janë shpallur në kërkim, pasi kanë qëlluar në drejtim të policisë. Mësohet se ngjarja ka ndodhur dy ditë më parë në fshatin Baltëz të këtij rrethi. Rreth orës 17:45 të së martës, policia është njoftuar se në fshatin Baltëz, në afërsi të varrezave, ka të shtëna me armë zjarri. Menjëherë në vendngjarje kanë shkuar uniformat blu, të cilët konstatuan se dy shtetas ishin duke bërë qitje me armë zjarri. Punojësit e policisë janë vënë në ndjekje, por dy agresorët kanë qëlluar në drejtim të tyre dhe kanë arritur të largohen. Në vendngjarje u sekuestruan 4 gëzhoja plumbash në cilësinë e provës materiale. Nga hetimet e kryera dhe nga informacionet e marra në rrugë operative u bë e mundur identifikimi dhe shpallja në kërkim e dy autorëve të dyshuar. Bëhet fjalë për shtetasit me inicialet H.M. dhe K.M., të cilët janë shpallur në kërkim. Policia po punon intensivisht për kapjen dhe arrestimin e tyre.

Shkëlqim Selami nën akuzë për falsifikim vlash e dokumentesh

Përfundon në gjykatë ish-deputeti i Vlorës, prokuroria: Nuk tregoi për arrestimin në Itali



Shkëlqim Selami, ish-deputeti i Vlorës

AKUZA

Sipas organit të akuzës, Shkëlqim Selami ka mashtruar me formularin e vetëdeklarimit, ku nuk pasqyroi arrestimin e tij në Itali. Ish-deputeti ka rënë në pranga në vitin 2006 në ekzekutim të masës së sigurimit "arrest me burg", lëshuar nga Gjykata e Brindisit.

ja e formularit të vetëdeklarimit të pandehurit, vihet re se ky shtetas i është përgjigjur me "JO" pyetjes nëse është caktuar ndaj tij ndonjëherë ndonjë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi, ose jo. Ndërkohë organi i akuzës thekson se referuar dokumentacionit të administruar në përgjigje të letërposisë së autoriteteve

italiane të drejtësisë, rezultoi se provuar se i pandehuri Shkëlqim Selami është arrestuar në vitin 2006 në ekzekutim të masës së sigurimit "arrest me burg", lëshuar nga Gjykata e Brindisit në vitin 1994, për veprën penale të "Pjesëmarrjes në organizatë kriminale me qëllim emigracionin klandestin". Në datë

06.09.2006 masa e sigurisë është hequr dhe në datë 07.02.2007 Gjykata e Brindisit ka dhënë vendimin për shuarjen e veprës penale për arsye parashkrimi. Në këtë kushte, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka dërguar për gjykim procedimin penal në ngarkim të të pandehurit Shkëlqim Selami, i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Falsifikimi i vullave, stampave dhe formularëve".

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'LIA ELEZI'

PASURINË NR. 2/963-ND+1-43 . E LLOJIT 'APARTAMENT', VOLUMI 55 , FAQJE 73, ZONA KADASTRALE 8513 , ME SIPERFAQJE 67.81 M2 . NË ADRESËN : RRUGA "K. KERTUSHA" , SHKALLA 1, KATI 7 , DURRËS . NË PRONËSI TË SHITËTASVË : Z. LUTFI GJYZELI DHE ZNJ. ENKELEJDA GJYZELI .
ÇMIMI 2.000.000 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'LIA ELEZI'

Pasuria nr. 7/392 - G8, e llojit 'Garazh', volumi 20, faqe 143, zona kadastrale 8370, me sipërfaqje totale 19.94 m2, në pronësi të SHOQËRISË "IN CO" SHPK, NUIS: J62410017G, me adresë: Rruga "4 Dëshmorët", Tiranë .
ÇMIMI 2.000 EURO. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 11.04.2018
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'LIA ELEZI'

Pasuria nr. 109 / 229 + 3 - 6, e llojit 'Apartament', zona kadastrale 3292, volumi 24, faqe 166, sipërfaqje totale 110, 5 m2, në pronësi të AMARILDO NAÇO, me adresë : Sellitë , Tiranë .
ÇMIMI 5.890.500 LEKË . Data e zhvillimit të ankandit do jetë 12.04.2018 .
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

Pallati i ndërtuar nga 53-vjeçari, banorët: Apartamentet janë blerë me kontrata të rregullta

Kokainë në Kolumbi, nis sekuestrimi i pronave të biznesmenit

Prokuroria: Luan Spahiu i përfitoi paratë nga trafiku i drogës

Biznesmeni Luan Spahiu, i cili dyshohet se ka përfutur pasuri nga trafiku i kokainës, po përballë me sekuestrimin e pasurisë. Oficerë të Policisë Gjyqësore të Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe të Drejtësisë së Policisë së Tiranës janë paraqitur ditën e djeshme në pallatin e ndërtuar nga Luan Spahiu, në rrugën "Marko Boçari" në Tiranë. Pas hetimit të Prokurorisë, Gjykata ka pranuar kërkesën për sekuestrimin e aseteve në vlerë 10 milionë dollarë të Spahiut, pasi ai rezultoi i dënuar në Gjermani me 5 vite burg për trafik kokaine. 53-vjeçari është dënuar për trafikimin e sasive të mëdha të kokainës nga Kolumbia drejt Gjermanisë dhe vendeve të tjera. Organi i akuzës thotë se 53-vjeçari nuk i justifikon pronat dhe për këtë arsye ka nisur edhe një hetim pasuror. Por oficerët e policisë hasën në kundërshtimin e banorëve, të cilët pretendojnë se i kanë blerë apartamentet me kon-



Pallati i ndërtuar nga biznesmeni Luan Spahiu

trata të rregullta nga ndërtesa. Sakaq paratë e fituara nga kjo linjë e trafikut të kokainës, dyshohet se Spahiu i kishte investuar në kompaninë e ndërtimit "Pinar" në Tiranë, si dhe në disa troje ndërtime dhe sipërfaqe toke në Selitë dhe në rrugën "Naim Frashëri". Mësohet se në 21 prill 2004 Spahiu ka themeluar kompaninë e ndërtimit "Pinar Shpk", ndërsa në datën 26 gusht

2010 Spahiu ka vendosur të largohet nga kjo kompani dhe t'i shesë biznesin e ndërtimit një shtetase të huaj, të quajtur Sandra Patricia Marquez Neira, nga Bogota e Kolumbisë. Ndërkohë që në 14 gusht 2012, kjo kompani ka ndryshuar statusin ekonomik, duke e pezulluar aktivitetin. Pas hetimit të Prokurorisë, Gjykata vendosi që 32 apartamente me sipërfaqe 3400 m² të seku-

strohen. Sekuestro u vendos edhe mbi tri njësi tregtare në të njëjtin kompleks, me sipërfaqe 230 m². Po ashtu një vilë tri katëshe në rrugën "Hoxha Tahsim", me sipërfaqe 340 m², si dhe disa garazhe u sekuestruan. Gjykata vendosi të njëjtin masë për dy sipërfaqe tregtare në rrugën "Naim Frashëri" dhe në Selitë, përkatësisht 5600 metra dhe 18 mijë m², si dhe tri automjete të shtrenjta.

Skandali me pronat në Lezhë, arrestohet një person i shpallur në kërkim

TIRANË - Hetimi mbi tjetërsimin e pronave në Lezhë, ka çuar ditën e djeshme në pranga një tjetër person, i cili dyshohet të jetë pjesë e skemës së skandalit. Burime zyrtare nga policia bëjnë me dije se bëhet fjalë për Lekë Frroku, i cili ishte shpallur në kërkim. Sipas policisë në vijim të operacionit "Ranishtja 4", ku u arrestuan 12 shtetas dhe u shpallën në kërkim 11 shtetas të tjerë, ditën e djeshme specialistët për Hetimin e Krimit Ekonomik Financiar në D.V.P. Lezhë, në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Korruptive në Policinë e Shtetit si dhe me Sektorin për Hetimin e Korrupsionit në Departamentin e Policisë Kriminale është bërë kapja dhe ndalimi i shtetasit Lek Frroku, 47 vjeç, banues në Mamurras. Ndaj këtij shtetas Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë me Vendim Nr.86, datë 15.03.2018, ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg", për veprën penale "Falsifikim i dokumenteve". Ndërkohë vijon puna për kapjen e personave të tjerë të shpallur në kërkim. Mes 23 urdhër arresteve që u lëshuan lidhur me skandalin, i arrestuar ishte edhe kreu i Bashkisë së Lezhës, Fran Frrokaj, i cili u liruar pak ditë më pas, ndërsa iu caktua masa "arrest shtëpie". Zyrtarët e bashkisë akuzohen se kanë abuzuar me një sipërfaqe toke, që është shndërruar me dokumente të falsifikuara nga tokë shtetërore, në bregdet, në tokë arë dhe pemtore.



VACANCY ANNOUNCEMENT

The Health for All Project (HAP) in Albania is funded by Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and is being implemented by a consortium of three organizations: the Swiss Tropical and Public Health Institute (Swiss TPH), and the NGOs Terre des hommes (TdH) and Save the Children (SC), through HAP Center. The Project started in January 2015 and will have an implementation timeframe of 4 years. Its overall goal is that the Albanian population, particularly the most vulnerable, benefit from better health due to improved Primary Health Care (PHC) services and health promotion activities.

Save the Children is recruiting for motivated and experienced staff for the project "HAP project"

Post title: **Procurement Assistant for HAP project**
Albania Country Office
Application deadline: **3rd April 2018, 1:00pm**

The Procurement Assistant for HAP maintain effective procurement and logistic system, supporting the project to deliver objectives effectively and efficiently.

REQUIRED QUALIFICATIONS AND EXPERIENCES



- Bachelor degree in Management, Administration or relevant equivalent qualification with relevant experience in the field of procurement/logistic.
- Communication skills both written and verbal in order to establish effective relationships with a wide variety of internal and external audiences.
- Good understanding of the Albanian market.
- 5 years of experience in implementing procurement for different public and/or private organizations and/or technical cooperation projects. Extensive knowledge of procurement procedures and guidelines would be an asset.
- Previous experience in a logistic/administrative role.
- Strong attention to detail and organizational skills.
- Ability to work in a challenging environment.
- Solution focused with the ability to work under pressure, quickly and flexibly.
- Empathy with the values and objectives of SC and the Swiss Agency for Development and Cooperation.
- Good written and spoken Albanian and English language skills.
- Computer literate and internet applications.

Information regarding the duties and responsibilities (Job Description) you may find on the website of Save the Children <https://albania.savethechildren.net/jobs>

Interested candidates should submit the following within the application deadline:

- 1- Cover letter clearly explaining your motivation for applying your motivation for applying for the position and how you meet the position criteria;
- 2- Detailed CV
- 3- List of reference with contact details

Application should be sent by email with subject "Procurement Assistant – HAP project" to the address below.



Pak ditë para ngjarjes, autori lëvizi me makinën e viktimës

I arrestuari për vrasje "kyç" gojën, ja si e ndoqi biznesmenin Elsi Kosiqi deri në Maqedoni

DIBËR - Një ditë pas ekzekutimit me kallashnikov të biznesmenit Elsi Kosiqi, janë zbardhur detaje të reja në lidhje me ngjarjen. Burime nga policia e Dibrës pohuan se mëngjesin e së hënës, 32-vjeçari Kosiqi nga fshati Maqellarë ka shkruar në Dibrë të Madhe ku kishte qëndruar me disa shqiptarë dhe një shtetas maqedonas gjatë gjithë ditës, deri në mesnatë. Po atë ditë, në Dibër të Madhe ka qenë dhe autori i krimit, Mahmut Gega. Ndërkaq, mësohet se 24-vjeçari nga Shupenza nuk rezultoi të ketë kaluar nga pika e Kalimit Kufitar të Blatës, ndaj ai ka hyrë ilegalisht në Maqedoni. Nisur nga ky fakt, dyshohet që Gega kishte planifikuar që ta vriste në Dibër të Madhe biznesmenin Kosiqi. Ndërkaq, mësohet se disa ditë para ngjarjes, autori i krimit është parë duke lëvizur me makinën tip "Benz" në pronësi të viktimës. Ndërsa, një ditë para vrasjes së babait të tre fëmijëve, Mahmut Gega ka hedhur në profilin e tij "Facebook" foto të automjetit



Viktima, Elsi Kosiqi



Autori i krimit, Mahmut Gega

NGJARJA

Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 01:30 të së martës në fshatin Maqellarë të Dibrës. Biznesmeni Elsi Kosiqi sapo ishte kthyer nga Maqedonia dhe po mbyllte portën e banesës së tij, kur u qëllua për vdekje me tre plumba në gjoks nga i riu Mahmut Gega, i cili u arrestua në kohë rekord nga policia.

të 32-vjeçarit Elsi Kosiqi. Nuk dihet nëse konflikti mes vrasësit dhe viktimës të ketë nisur për makinën. Policia e Dibrës deklaroi pas vrasjes se ngjarja ka marrë shkas për motive të dobëta. Ndërkaq, ekzekutori Mahmut Gega nuk ka pranuar të flasë gjatë marrjes në pyetje nga policia. Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 01:30 të së martës në fshatin Maqellarë

të Dibrës. Biznesmeni Elsi Kosiqi sapo ishte kthyer nga Maqedonia dhe po mbyllte portën e banesës së tij, kur u qëllua për vdekje me tre plumba në gjoks nga i riu Mahmut Gega, i cili u arrestua në kohë rekord nga policia. 31-vjeçari që u ekzekutua ishte pronar i një hoteli 5 katesh tek Llixhat në Peshkopi.

"Zogu i kokainës", ja kush është shqiptari që kërcënoi gazetarin Lirio Abbate

ITALI

Itali, shkatërrohen dy organizata të lidhura me 'Camorra'-n e 'Ndrangheta'-n

Trafik droge dhe armë, karabinierët vunë në pranga 16 persona, mes tyre dhe shqiptarë

Dy organizata kriminale të lidhura me "Camorra"-n dhe "Ndrangheta"-n janë shkatërruar nga policia italiane. Operacioni nisi në orët e para të mëngjesit të djeshëm, ndërsa morën pjesë rreth 200 karabinierë të komandës provinciale të Romës në bashkëpunim me të Napolit, me helikopterë dhe qen antidrogë për ekzekutimin e urdhrave të arrestit për 19 persona, mes tyre një grua dhe disa shqiptarë. Ndërkohë, mediat italiane bënë me dije se për 16 prej tyre është dhënë masa e arrestit me burg, ndërsa për 3 arrest shtëpie. Mësohet se operacioni i karabinierëve ka marrë shtysë nga prokuroria e Romës, me kërkesë të Drejtorisë së Antimafias. Akuzat janë për organizatë kriminale me qëllim trafikun e kokainës, në rrethana të rënduara nga përdorimi i armëve. Dy prej të arrestuarve iu është shtuar ndër të tjera edhe akuzat për lëndime të rënda, të kryera me armë zjarri dhe në mënyrë mafioze. Hetimet e karabinierëve në Romë arritën në përfundimin se në kryeqytetin italian operonin dy organizata kriminale, të dyja të armatosura dhe të përfshira në narkotrafik, me bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën. Mësohet se njëra prej tyre, me karakter mafioz e me ndikim nga "Camorra", e udhëhequr nga vëllezërit Salvatore dhe Gemi Esposito, bijtë e Luigi-t, i njohur ndryshe si "Nacchella", ndërsa tjetra me drejtues Vincenzo Polito, që kishin lidhje me eksponentët të "Ndranghetas" në provincën e Reggio Calabria, familjet Filippone dhe Gallico. Mes urdhër-arresteve të lëshuara është edhe një për shqiptarin e njohur për lidhjet e tij mafioze, Arben Zogu, i cili sipas mediave italiane ka qenë në herët i arrestuar për trafik kokaine. Operacioni i autoriteteve italiane vazhdon dhe në total janë lëshuar 44 urdhër-arreste.

KUSH ËSHTË ARBEN ZOGU

Në një operacion tjetër në vitin 2015, Arben Zogu i njohur ndryshe dhe si: Rikardino, "Ricky", ose l'albanese (shqiptari) ishte mes nëntë të arrestuarve. Shtija e kokainës dhe mbledhja e gjobave ishte aktiviteti kryesor i shqiptarit dhe drejtonet pjesën që kishte lidhje me Shqipërinë. Po ashtu në vitin 2013, ish-krahu i djathtë i bosit italian të "Camorres", i ka dërguar një mesazh kërcënues gazetarit të njohur italian, Lirio Abbate. Ai e paralajmëronte të kishte kujdes kur shkruante artikuj, ku përmendte shefin e tij, sepse "ka njerëz që qëllojnë". Hetimi, i koordinuar nga prokurorët në Romë, vuri në dukje se grupi ishte




Operacioni i djeshëm në Itali



Gazetari Lirio Abbate



Ish-boksieri, Oriol Kolaj



I burgosuri që tentoi të grabiste bankën

"prodhon" thika në qeli

FIER - Edhe pse vuan dënimin në burgun e sigurisë së lartë të Fierit, për tentativën e vjedhjes së një banke në Tiranë, vazhdon të kryejë vepra të tjera penale në qeli. Nazmi Çaka, 22 vjeç nga Durrësi, është pikasur me sende të dyshimita në qeli, ndërsa nga kontrolli i janë gjetur armë të ftohta që dyshohet se i ka prodhuar vetë. Mësohet se mbërrynte më 15 marsit, pas një kontrolli të ushtruar në qelmin e Çakës, grupi i gatshëm ka konstatuar në dysheme një tigan të deformuar, ku një pjesë anësore i mungonte. Ndërsa në zgarë e dritares së dhomës është gjetur pjesa që i mungonte tiganit. Mësohet se me këtë pjesë tiganit ishte përshatur një thikë, mjet prerës me gjatësi totale 14 cm. Thika e krijuar ishte mbështjellë me leckë ngjyrë blu në formë doreze dhe dyshohet se mund të përdorej nga 22-vjeçari gjatë ndonjë konflikti të mundshëm. Veç thikës së improvizuar, në qeli është gjetur edhe një uzazë e krijuar me pjesë tjetër të tiganit që dyshohet se mund të përdorej për të sulmuar me grusht. Por, gardianët e burgut dhe oficerët e policisë gjyqësore që kanë këqyrrur vendin e ngjarjes nuk kanë arritur dot të gjejnë mjetet, me të cilat është prerë tiganit dhe me të cilat i është dhënë forma dhe mprehtësia thikës e uzazës së improvizuar. Vetë Çaka nuk ka qenë bashkëpunues dhe nuk ka treguar se si i kishte krijuar armët e ftohta. I riu është proceduar për veprën penale "Futja ose mbajtja e sendeve të ndaluara në institucionin e ekzekutimit të vendimeve me burgim". Më 5 mars të vitit të kaluar, Nazmi Çaka u akuzua se tentoi të grabiste një bankë në kryeqytet.

44

URDHËR-ARRESTE

Në operacionin e djeshëm morën pjesë rreth 200 karabinierë të komandës provinciale të Romës në bashkëpunim me të Napolit. Gjatë këtij operacioni u arrestuan 19 persona, mes tyre një grua dhe disa shqiptarë. Mediat italiane bënë me dije se për 16 prej tyre është dhënë masa e arrestit me burg, ndërsa për 3 arrest shtëpie. Mësohet se operacioni i autoriteteve italiane vazhdon dhe në total janë lëshuar 44 urdhër-arreste.

KËRCËNIMI I GAZETARIT

Pas arrestimit të Senses vjen paralajmërimi për rrezik, pasi asokohe Zogu ishte ende i lirë. Rikardino, i cili vepronte në zonën e Urës Milvian, kishte udhëzuar njerëzit e tij, "njerëzit që qëllojnë" për të vrarë gazetarin e pavarur, Lirio Abbate. Aq i besuar dhe pushtet kishte Zogu, sa që kur dikush në Triassi apo Ostia donte të kuptonte se kush është autor i një sulmi, duhet t'i drejtohej Rikardinos dhe Michele.

BOKSIERI

Njerëzit që menaxhonin biznesin e videopokerit përdornin tre shqiptarë për të imponuar instalimin e makinave. Oriol Kolaj, një boksier me origjinë shqiptare, i cili fitoi në vitin 2012 kampionatin italian të peshave të rënda, së bashku me dy bashkatdhetarët, Arben Zogu dhe Petrit Bardhi, ishin "autorët e akteve të dhunës së frikësimit". Nga përgjimet dalin frazat "Oriali është një makinë lufte".

përbërje e 'Camorres' dhe më saktë klanit kazalezi. Dega e udhëhequr nga Arben Zogu shtrihet në zonën Capoline, ku kishte fituar respektin e krerëve mafiozë atje. Marrëveshja kryesore ishte shtija e drogës në Romë, siç u shfaq edhe në hetim. Hetuesit kanë zbuluar një dërgesë prej 20 kg kokainë nga Spanja, një operacion që u ndoq nga trafikanti i drogës Elis

Çoku (Santa Lusia) si furnizues, trupëroja Petrit Bardhi (Titi), Elvis Demçe (Çezari), i arrestuar kohët e fundit si nxitës i vrasjes së Federico De Meo dhe Hektor Ibrahim, (Pluto). Gazetari i pavarur thelloi artikujt dhe në shkrimin e 13 dhjetorit 2013 publikoi në "L'Espresso" një hartë të përditësuar me emrat dhe mbiemrat e njerëzve me ndikim në botën e kriminit, duke u përqendruar në

personazhet "Far-west", ku një prej katër mbretërve të Romës ishte Michael Sense, që ndryshe thirrej si "i cmenduri". Menjëherë pas arrestimit të Senses vjen paralajmërimi për rrezik, pasi asokohe Zogu ishte ende i lirë. Rikardino, i cili vepronte në zonën e Urës Milvian, kishte udhëzuar njerëzit e tij, "njerëzit që qëllojnë" për të vrarë gazetarin. Aq i besuar dhe pushtet

kishte Zogu, sa që kur dikush në Triassi apo Ostia donte të kuptonte se kush është autor i një sulmi, duhet t'i drejtohej Rikardinos dhe Michele. Ata kishin ngritur një monopol në menaxhimin e dhunshëm të videopokerit dhe basteve. Nga hetimi doli sesi në vendbanimin Aciliaklani, klani i kazalezëve kishte arritur të siguronte monopolin e instalimit të dhunshëm, shpërndarjen dhe dhënie me qira të slot-makinave, bastet dhe lojërat. Njerëzit që menaxhonin biznesin e videopokerit përdornin tre shqiptarë për të imponuar instalimin e makinave. Oriol Kolaj, një boksier me origjinë shqiptare, i cili fitoi në vitin 2012 kampionatin italian të peshave të rënda, së bashku me dy bashkatdhetarët, Arben Zogu dhe Petrit Bardhi, ishin "autorët e akteve të dhunës dhe frikësimit". Kur pronari i një pike lojërash refuzonte instalimin e makinave, atëherë treshja e shqiptarëve hynte në veprim. Nga përgjimet dalin frazat "Oriali është një makinë lufte".

TEATRI KOMBETAR QENDRIMET

FORUM/ Aktorët e njohur kundër 6 kullave: Të mos bëhet me PPP, ka para që ta ndërtojë shteti

Teatri i ri, artistët: Xhungël urbane

Robert Ndrenika: Jo partneritet me privat. Liçaj: Silluni si të majtë!

Projektet arkitektike dan ez Bjarke Ingels për Teatrin e ri Kombëtar, që u prezantua nga kryeministri Rama, ka hasur në kundërshtimet e ashpra të komunitetit artistik. Projekti parasheh një godinë tri katesh me biznese brenda, që për t'u ndërtuar do t'i japë sipërmarrësve lejen për 6 kulla të larta afër saj. Ndonëse kryeministri tha se teatri nga 3 mijë metra bëhet 9 mijë metra (tashmë prej 3 kateve), artistët kanë 1 muaj që flasin për 6 mijë metra truall të teatrit, që më projektin e ri, i humb 3 mijë, të cilat duket se do të shërbejnë si 'pagesë' për ndërtimin e një godine me beton e xham. E denjë për shumë qytete të botës, pjesëtarë të komunitetit artistik, e gjejnë pa vend.

REAGIMET E ARTISTEVE ROBERT NDRENIKA

Dy prej figurave më të zëshme kundër shembjes së Teatrit Kombëtar, të cilët e kanë kundërshtuar projektin Rama që në gjezëzë ish-in Robert Ndrenika dhe Bujar Asgeriu.

"Kryesja është se mua më shqetëson shumë ai partneriteti me privatin. Unë jam i bindur se shteti nuk e ka problem të ndërtojë një Teatër Kombëtar. Dhe këtë nuk ma heq njeri nga mendja. Shembull kam. Shteti fqinj Maqedonia, që nuk po e respekton Marrëveshjen e Ohrit, që nuk po i respekton shqiptarët, ama po u ndërton atyre një teatër. Po e bën vetë, pa partneritet publik privat.

Prandaj do iu lutesha shumë kryeministrit, zonjës ministre që të heqin dorë nga partneriteti privat dhe të gjejnë fonde. Kjo mund të bëhet. Sepse kjo që është këtu, ishte një dyndje, një xhungël urbane. Ajo u duk e bukur se duket si kartolinë, por do të shihni se çdo të bëhet. Pra, unë jam i mendimit, që të shtyhet edhe ca kohë, nëse duhet. Por ama shteti të ndërtojë Teatrin e ri Kombëtar", deklaroi aktori i madh, Robert Ndrenika.

BUJAR ASGERIU

Për sa i përket projektit të prezantuar nga kryeministri Rama, Bujar Asgeriu theksoi se në atë takim artistët u fyen, pasi iu prezantua një



projekt pa u konsultuar më parë.

"Shpejtësia me të cilën u paraqit ai projekt, pa asnjë konkurs, më duket se ishte i gabuar. Dhe i gjykuar në këtë sens, është jo vetëm i gabuar, por me shumë gabime brenda. Dhe pa u konsultuar dhe pa marrë mendimin e atyre që ishin të fuqar aty të paktën, është një fyerje shumë e madhe. As i pyeti, as asgjë, punë e tij si e mendon. Teatri ekzistues është i kalbur në të gjitha drejtimet, sepse prej vitesh nuk është hedhur asnjë gjë. Por cila është më e rrezikshmja? Më e rrezikshmja për mua, në tërë prapavijën e Teatrit, gëlojnë viruse shumë të rrezikshme jo vetëm për aktorët, por edhe për spektatorët. Prandaj rikonstruksioni i atij teatri duhet të jetë me themel", tha Asgeriu.

ARBEN DERHEMI

Aktori Arben Derhemi ishte njëri prej artistëve që u la jashtë takimit me kryetarin e qeverisë. Më pas, ai sqaroi se ishte "një mbledhje për të diskutuar për projektin e djeshëm. Ne që s'ishim, ne armiqtë e klasës, pati urdhër nga drejtori që nuk na u lejua të hyjmë në godinën e TK. D.m.th. aty ku ne punojmë nuk lejohejmë të hyjmë. Një projekt, i cili nuk ka lidhje me klasikun e TK. Me qelq e pamë TK, shiheshin aktorët se si visheshin, se si zhvisheshin, do të futen nga poshtë kur t'i zërë shiu. U kënaqem ne".

ANILA BISHA

Ndonëse kishte mes

QENDRIMI

Bujar Kapexhiu: Teatri i prezantuar nga Rama? Dyshoj për vlerën e tij funksionale

Në një intervistë për "Gazetën Shqiptare", sa i takon projektin të qeverisë për Teatrin, artisti i njohur Bujar Kapexhiu thotë se "në tezgën qeveritare të shitjes për ne blerësit artistë, ky produkt nuk preferohet, sepse kjo godinë, me formën e saj moderne, mund të qëndrojë në çdo hapësirë të bulevardit të ri, ku priten të ndërtohen ndërtime moderne, ndërsa në sheshin ku është teatri sot, ajo stonon me konfiguracionin e saj dhe nuk lidhet me godinat e tjera që ka rreth e rrotull".

- Si ju duket projekti i qeverisë?

Projektet arkitektike dan ez Bjarke Ingels për Teatrin e ri Kombëtar, që u prezantua nga kryeministri Rama, ka hasur në kundërshtimet e ashpra të komunitetit artistik. Projekti parasheh një godinë tri katesh me biznese brenda, që për t'u ndërtuar do t'i japë sipërmarrësve lejen për 6 kulla të larta afër saj. Ndonëse kryeministri tha se teatri nga 3 mijë metra bëhet 9 mijë metra (tashmë prej 3 kateve), artistët kanë 1 muaj që flasin për 6 mijë metra truall të teatrit, që më projektin e ri, i humb 3 mijë, të cilat duket se do të shërbejnë si 'pagesë' për ndërtimin e një godine me beton e xham. E denjë për shumë qytete të botës, pjesëtarë të komunitetit artistik, e gjejnë pa vend.

QENDRIMI I EDI RAMES

"Nga se vuajnë aktorët, mos duhet tua shpërndajë qeveria rolet? Mos duhet të ringrejme Kinostudion Shqipëria e re dhe të rihapim punë? Mos duhet që t'u vëmë tapetin e kuq e të vijmë të bëjmë shfaqje, përse? Beteja është komplet pa përmbajtje, siç është pa përmbajtje e gjithë mënyra juaj e degradimit të debati", -deklaroi Rama në Kuvend.

KASTRIOT ÇIPI

Ish-drejtori i teatrit Eksperimental, Kastriot Çipi, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ngriti pyetjen se a është plagjiaturë e arkitektit danez apo paljaçatë e pushtetit?

Çipi ka shkruar se projekti i Ramës për TK është, në fakt, projekti i studios ukrainase "Forma", fitues i çmimit të tretë (pra i skuallifikuar) në konkursin për Operën e Busanit në Korënë e Jugut.

NERITAN LIÇAJ

Aktori Neritan Liçaj e ka parë "shfaqjen" e Ramës për Teatrin e ri Kombëtar nga televizioni.

"Nuk kuptova shumë. Do ishte mirë që ta kisha parë atje, po nuk ka rëndësi. Shumë mirë bënë që s' më thirrën, e panë kolegët e mi e shumë mirë bënë që shkuan në prezantim. Nuk kam asnjë kundërshtim. Mirë është të tregohen projektet, se deri tani jemi mbajtur pak në mjegull, me deklarata e kundërdeklarata. Më shumë se sa me projektin dua të merrem pak me këtë filozofinë e tri P-ve që na është kthyer gogol në Shqipëri. Partneriteti publik privat, dhe sinqerisht habitem pse duhet të jetë kudo. Nuk jam kundër po pse duhet të jetë kudo? Pse duhen futur qofte në Butrint, pse duhet grishur teatri dhe i duhet dhënë biznesit disa metra? Tek institucionet kombëtare duhet të jesh ti si shtet, te Stadiumi Kombëtar, te Teatri Kombëtar, te Opera Kombëtare, te Galeria Kombëtare, te Biblioteka Kombëtare. Sepse qeveritarët për veten kanë para për udhëtime në klas të parë e më gjerë, por jo për institucionet. Po pse kur vjen puna të arti e kultura nuk ka lekë, mua kjo më shqetëson".

Duke rivënë theksin të humbja e truallit, Liçaj shtoi se kjo është qeverisje e majtë dhe kryeministri duhet të jetë më pranë qytetarëve jo pranë biznesit siç po bën. Madje bën mirë që rri pranë biznesit, por jo vetëm për biznesin.

Ish-drejtori i teatrit Eksperimental, Kastriot Çipi, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ngriti pyetjen se a është plagjiaturë e arkitektit danez apo paljaçatë e pushtetit? Çipi ka shkruar se projekti i Ramës për TK është, në fakt, projekti i studios ukrainase "Forma", fitues i çmimit të tretë (pra i skuallifikuar) në konkursin për Operën e Busanit në Korënë e Jugut.

GENC FUGA

Aktori i njohur Genc Fuga prej kohësh është anëtar i Partisë Socialiste. Ai e mori taserën në një nga takimet që transmetoheshin drejtpërdrejt të kryeministrit, jo pa batuta. Kohë më vonë, raporti i tij me PS-në, nuk duket i njëjti. Fuga, ishte një prej zërvave kundërshtarë sa i takon ligjit të ri për artin dhe kallimit të trupës së aktorëve nga godina e TK-së në qendër, tek ambientet e Turbinës. 1 muaj më vonë, ai është kandidat për drejtor i Teatrit Kombëtar, e me gjithë sa më lart, në takimin e ditës së hënë ku artistët qenë thirrur për t'u prezantuar projektin e godinës së re të TK-së, Fuga, nuk u thirr.

I pyetur nëse si formë proteste, artistët do lënë shfaqjet, do bëjnë grevë apo do të mbajnë çfarëdo lloj organizimi tjetër kundërshtues ndaj projektit, ai tha se nuk kanë një strategji të qartë.

Më pas, "GSH", këmbënguli të dijë, të ardhmen e raporteve të tij me PS. Pyetjes nëse pas gjithë kësaj që ka ndodhur, a do ta dorëzojë ai taserën e partisë, Fuga iu përgjigj: "Nuk mendoj që është ky diskutimi. Jam futur për një ideal të caktuar. Të mbarojë edhe lufta ideale, pastaj pse jo. Por të shterojnë të gjitha mjetet e mia personale të luftës".

SHKRIMTARET NE DIKTATURE DOKUMENTET

EKSKLUZIVE / Zbulohet informacioni sekret i vitit 1973, i Ksenofon Dilos për Ramiz Alinë, lidhur me "ndikimet e huaja moderniste" në radhët e piktorëve dhe skulptorëve

Raporti për Ramizin: "Bakalli, Gjergo, Velo, Oseku dhe Shima, tablo me ndikime të huaja"

Hamid Beqja: "Shoku Ramiz, në dosje kemi riprodhime pikturash, t'ia japim edhe shokut Enver"



Dashnor Kaloçi

Nëder mbledhjet e shumta që u bënë në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të Tiranës në fillimin e vitit 1973 pas fjalës së Enver Hoxhës e mbajtur më 15 e 16 mars në aparatit e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte "Lufta kundër shfaqjeve të huaja e liberale në art e kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vëndit...", edhe në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe artistëve u mbajtën një sërë mbledhjesh ku u morën në analizë puna e bërë deri në atë kohë dhe detyrat që u dëllnin artistëve dhe shkrimtarëve në të ardhmen, "nën frymën fjalës së shokut Enver të mbajtur në Pleniumin e IV-të". Një ndër këto mbledhje të mbajtura në muajin maj të atij viti në Lidhjen e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, ishte edhe ajo e sektorit të arteve figurative, ku pas saj, në bazë të rregullave mbi të cilat funksiononte Lidhja, sekretari përkatës, Ksenofon Dilo, (Sekretar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për artet figurative), ka përpiluar raport-informacionin përkatës për Komitetin Qendror të PPSH-së. Po kështu, një raport-informacion tjetër për këtë mbledhje, është mbajtur nga Kujtim Buza, i cili në atë kohë mbante funksionin e sekretarit për artet figurative në Ministrinë e Arsimit dhe Kulturës, raport i cili së bashku me atë të Ksenofon Dilos, i janë dërguar Ramiz Alisë, me një shënim që ka bërë aty, Hamit Beqja, ndihmës i Ramiz Alisë, në sektorin e edukimit pranë aparatit të Komitetit Qendror të PPSH-së. Ajo që vihet re tek të dy raport-informacionet në fjalë, është fakti se aty duket që është pasqyruar me "korrektesë dhe vërtetësi" gjithçka është thënë dhe folur nga pjesëmarrësit, piktorë, skulptorë, kritikë arti etj., pasi përveç kritikave apo më saktë akuzave që janë bërë ndaj Edison Gjergos, Ali Oseku e Maks Velos, të cilët, siç dihet, përfundon burgjeve të regjimit komunist për vite të tëra, (këto raporte ishin dhe "lënda e parë" e baza për



Dashnor Kaloçi me piktorin Ali Oseku

mbushjen e dosjeve të tyre), autorët e raporteve nuk kanë kursyer as piktorë dhe skulptorë të tjerë, emra mjaft të njohur të arteve figurative si p.sh. Sali Shijaku, Muntaz Dhrami, Guri Madhi, Nexhmedin Zajmit, etj., të cilët jo vetëm që nuk patën probleme më pas, por përkundrazi ishin mjaft të vlerësuar. Po çfarë thuhet më tej në dy raport-informacionet e përpiluara nga Ksenofon Dilo dhe Kujtim Buza, kush ishin piktorët dhe skulptorët e tjerë që u kritikuan apo u akuzuan aty për ndikime moderniste dhe shfaqje të huaja në punimet e tyre? Lidhur me këtë na njeh dokumenti në fjalë që publikohet për herë të parë në faqet e këtij libri (ai i Ksenofon Dilos, të cilin po e japim të plotë dhe pa asnjë shkurtime).


SHENIMI I HAMIT BEQES PER RAMIZ ALINE

Shoku Ramiz. Në dy materialet për artet figurative, ka edhe problem të pasqyruara gjer në fund si dhe..... (nuk kuptohet shkrimi) kuptimesh të ndryshme të tyre. Do të kërkojmë që këto trajtime të bëhen më të plotë në Pleniumin e Lidhjes për artet figurative.

Në dosje kemi edhe disa riprodhime pikturash e skulpturash



Dashnor Kaloçi me piktorin Maks Velo



INFORMACION MBI LUFTEN KUNDER NDIKIMEVE TE HUAJA NE ARTET FIGURATIVE

Po japim një informacion paraprak mbi disa probleme të ndikimeve të huaja në artet figurative, që dojnë nga diskutimi në mbledhjen e komisionit pranë Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve. Një informacion më të plotë do ta japim pas pleniumit që do të marrë në shqyrtim gjëndjen e arteve figurative në këto vjetët e fundit, e që do të mblidhet nga fundi i muajit prill.

Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist", i gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

jo vetëm nga ato që janë kritikuar, por edhe nga ato që janë konsideruar me vlera. Mund të bisedojmë nëse duhet t'ia japim ato edhe shokut Enver. 20.IV.1973 Hamit Beqja

Të nisur nga materialet e fundit të Partisë, fjalimet e shokut Enver, duke vënë theksin në ndikimet e huaja e lëshimet liberale në terrenin e arteve figurative, të gjithë shokët që diskutuan u përpoqën të analizojnë llojet dhe shkaqet e këtyre ndikimeve. Në diskutime u vu në dukje se arti ynë i realizmit socialist, krijoi traditën e tij të shëndoshë në pikturë, skulpturë, e gjini të tjera, me vepra të shumta, vlera solide originale kombëtare, partishmëri të lartë dhe frymë popullore revolucionare. Prandaj në qoftë se ndalemi në disa çfaqje të huaja në artin tonë, i dalin majtas apo djathtas rrugës së tij revolucionare, këtë e bëjmë për të ruajtur tiparet më pozitive dhe frymën e shëndoshë të tij, fizionominë dhe pastërtinë kombëtare.

Ku, dhe si u dukën ndikimet e huaja në artet figurative?


Edhe më parë kemi pasur raste të veçanta veprash me ndikimet të huaja. Ato nuk i kemi ekspozuar dhe kemi ngelur me kaq. Vitet e fundit këto çfaqje ishin të shumta sidomos në ekspozitën e talenteve të reja, në atë me portretin e klasës punëtore, në ekspozitën e 30 vjetorit të Partisë, në ekspozitën e parë të pranverës së Tiranës dhe në ndonjë ekspozitë rrethi (Durrës, Shkodër), e personale (Skënder Kamberi, Nestor Jonuzi). Ndikime të huaja janë çfaqur edhe në skenografinë e teatrove tona, në grafikën e librit (kopertina dhe ilustrime) në pllakat.

Edhe më përpara ka patur një vazhde ndikimesh, numerikisht më të pakta (në pikturë) sidomos maniera impresioniste. (Këto punë karakterizohen nga një paqartësi e formës realiste, duke dhënë më tepër impresionin se sa thellimin dhe analizën e figurave e të ambientit). Por vitet e fundit në ekspozitat që përmendëm, ndikimet u dukën më të shumëllojshme.

Në disa raste si në ekspozitën e pranverës dhe në disa rrethe është vënë re një tematikë e



"Epika", pikturë nga Edison Gjergjo




Piktori Alush Shima



Piktori Ali Oseku



Edison Gjergjo në hetuesi



Piktori Maks Velo

← cekët me subjekte të parëndësishme, rendje të disave pas motiveve të vogla dhe të rastit.

Tek disa piktorë të rinj, gjatë përpjekjeve për të gjetur "mjete të reja shprehëse" u dukën ndikime të rrymave të artit të huaj. Siç doli nga mendimi i shumë shokëve, punime me premise të tilla kanë qenë: "Çrrënjosja" (Skënder Kamberi), "Zgjimi aksionist" (Nestor Jonuzi), etj. Ndërsa ndikime të dukshme të huaja u panë në tabllotë "Kur vjet mbushin qiellin" (Naxhi Bakalli), "Epika e jveve të mëngjezit", "Pusi 524", (Edison Gjergjo), "Radio Tirana", (Zef Mati), kemi patur pejsazhe, portre e ndonjë kompozim tjetër me kërkesa estetizante nga Ali Oseku, Llambi Blido, Alush Shima, Vilson Halimi, Kiriako Deno, Maks Velo, e ndonjë tjetër. Po ashtu kontradiktore dhe disi të paqarta kanë tingëlluar ndonjë punë e Edi Hilës, Arben Bashës, Nexhmedin Zajmit, Sali Shijakut etj.

Ndër punimet që përmëndim, të ekspozuara apo të paekspozuara, këto ndikime (përvç punimeve me tematikë të varfër e të cekët), dallohen në prirjen për të huajtur shprehje dhe teknika të artit bashkohës heterogjen formalist evropian (kryesisht nga ndonjë rrymë e fillimit të shekullit tonë), si të kubizmit, ekspresionizmit, simbolizmit etj. Kjo shprehjet në mënyrën e të konceptuarit të temës, në vizatimin e paqartë, në ngjyrat dhe format herë tepër të abstraguara e të egzaltuara, herë pa shprehje ose kontrastikë me përmbajtjen e pretenduar. Megjithëse nuk janë identike ato rryma, duke huajtur "dicka" prej tyre, këto punime ndodhen para ndikimesh të dukshme, duke zbehur e deformuar vërtetësinë reale, duke krijuar ndonjëherë ekuivoqe në përmbajtje dhe më se nënjëherë krijojnë një klishe tjetër skematizmi të pajetë. Përdorimi i mjeteve shprehëse (forma, vizatimi, kompozimi, ngjyra), shihen disi të veçuara nga tërësia ideostetike e veprës, e përmbajtjes së saj. Ndikime të këty llojve kemi patur në skenografinë e viteve të fundit. Ajo ç'qihet ose nga një ngarkim, stërmundim të objekteve në skenë, pa

tingull realiteti, ose në minimizimin e atmosferës së nevojshme, duke i reduktuar ngjdhjet skenografike në elementë dhe objekte reale, të thjeshtëzuar jashtë masës dhe llogjikës. Po ashtu janë vënë re shenja "modernizmi", e stilizimi pa kriter të kostumeve popullore që ndonjëherë humbasin originalitetin dhe vetë karakterin popullor të tyre.

Disa ndikime të huaja janë dukur edhe në grafikën e librit (sidomos kopertinat), ku ndjehet mungesë serioziteti dhe një farë shije komerciale reklamative. Po e njëjta gjë ka ndodhur në ndonjë pllakat të botuar ose të vendosur në qytet.

Duke ndaluar në shkaqet dhe atmosferën që lanë shkas për

ndikime të tilla, të gjithë shokët në mënyrë kritike dhe autokritike u përpoqën të zbulojnë dobësitë e kësaj natyre të krijimtarisë tonë.

Shoku Fatmir Haxhiu shprehu mendimin se disa ndikime fillojnë kryesisht që me diskutimin e ekspozitës të 30 vjetorit të Partisë, ku u përkrahën disa punime të dyshimta dhe u kritikuan punime të tjera duke u veshur epitetet strikte si "akademike", "letrareske", "shkollareske", "natyraliste", etj. Më tepër se kudo aty ka patur inkurajim për "forma" të reja - tha ai.

Shokë të tjerë i bashkonte mendimi se nuk duhet izoluar në një ekspozitë. Dobësi dhe vërejtje profesionale të ndryshme janë bërë për shumë vjet rresht.

Nga ana tjetër duke bërë vërejtje profesionale për një apo disa punë (si shkollareske, skematike, natyraliste), nuk ka pasur gjithmonë argumentime të sakta. Më se njëherë vërejtje të thjeshta profesionale, nga preference personale kanë marrë dukurinë e një platforme profesionale, ku në rrethë të ngushta, punime të tilla, tha Ksenofon Dilo, nuk është as e vertetë as e saktë por denigruese (skematizmi është edhe liberal, shkollarizmi s'ka të bëjë me asnjë platformë, ndërsa natyralizmi, bie fjala është edhe një prirje fare e fundit e "avangardizmit", formalist evropian). Duke i atribuuar njërit dhe tjetrit tendenca të tilla ka patur një konfuzion të theksuar dhe vënd për teozizime të dëshëmshme e të pa sakta.

Prej vitesh tha Foto Stamo, versioni "të rinjë të vjetër", nuk ka ndihmuar për një frymë më të shëndoshë krijonjëse. Disa punë nga gjykime subjektive - tha ai, u bënë flamur shëmbullor siç ishin "Epika e jveve të mëngjezit" (Edison Gjergjo), dhe "Mbjellja e pemëve", (Edi Hila). "Kam pasur vërejtje, për vlersimet lidhur me to, të shprehura në artikujt e Andon Kuqalit në "Drita" e në "Nëntori".

Arti ynë i ri çau dhe do të çante shtigje të reja. Në vitet '60-të, përvç armikut të tij tradicional, formalizmit dekadent borgjez, ju çfaq një tjetër armik, presioni revizionist. Lufta kundër çdo lloj ndikimi të lufta borgjez e revizionist mori propocionet të reja, duke i bërë ballë në tërësi e duke krijuar një sërë veprash të bukura revolucionare. Por vitet e fundit është neglizhuar në një farë mënyre kjo luftë. Kjo luftë në mjaft raste, në diskutimet tona krijonjëse është parë pak e nënjëshme, herë herës vetëm në formë, të çkëputura nga nga konteksti i përmbajtjes. Nga një kënd i tillë, vetë fjalët "novitet", "mjete të reja shprehëse", trajtohen veçmas nga tërësia e së resë, kryesisht në përmbajtje, duke lënë shkas për gjykime e shpërdorime të pavend. Kështu ndodhte me


vlersimin e ekspozitës së taleteve të reja. Aty u dukën ndikime fare të qarta të huaja në disa krijime, por vëmëndja jonë ndaj çfaqjesh të tilla u karakterizua nga një tolerancë e pajustificuar. Edhe kur në këtë ekspozitë u dukën ndikime liberale formaliste (në punime të Nestor Jonuzit, Skënder Kamberit, Zef Mati etj), dhe pati kritika (një diskutim i gjërë në Institutin e Arteve, ndonjë artikull, në "Nëntori" etj), prap se prap, problemet nuk u thelluan, mbetën të izoluar nën lëshimet sentimentale e pa parim, duke i marrur moshat e reja "en bloc" si pasuronjë të traditave tona artistike, pa analizuar, çkoqitur vlerat dhe jo vlerat e krijimtarisë të atorëve të diferencuar.

Siç thanë shumë shokë, nga një nivel i ulët teorik e kritik në trajtimin e disa problemeve ideo-estetike dhe profesionale të artit tonë, ka patur një farë konfuzioni ideo-estetik që ka lënë shkas për prirje subjektive vlersimi dhe teozizime, Andon Kuqali tha se e çqetësonte apatia e disa piktorëve të vjetër, inaktiviteti i tyre që ka shkaktuar edhe një rënie profesionale graduale të krijimtarisë së tyre, (motrat Zengo, Kaceli etj), si dhe krijimtaria e mbyllur nëpër ateliera si Janaq Paços, i cili ka shumë punime, studime figurash por pa ndonjë tematikë shoqërore, ndërsa në ekspozita sjell punime të dobëta. Ndërsa Edison Gjergjo, Naxhi Bakali dhe Alush Shima, thuhet se po punojnë shumë, por ne nuk i njohim këto përpjekje, nuk i kemi parë këto punime. Arti ynë tha Andon Kuqali ka patur ndikime të tjera sidomos nga impresionizmi dhe ndër piktorë më përvojë. (Nexhmedin Zajmi, Guri Madhi etj).

Edhe Vilson Kilica tha se arti ynë asimiloi disa ndikime impresioniste në manierë, prej shumë vjetësh (sidomos në pejsazhe, ndonjë portret, kompozim). Shumë nga ndikimet e sotme rrjedhin së pari sepse ndërmjet nesh në praktikë e teori ka koncepte estetizante. Ka një farë konfuzioni estetik dhe ndonjëherë koncepte të huaja e të palidhura me rrugën e shëndetshme të artit tonë. Zor se bën një ndarje të tillë të qartë, p.sh. Ali Oseku. Nuk kemi akoma një sens kritik të qartë ndaj krijimtarisë së huaj. Gjithashtu jo shumë të qartë e kemi të përpunuar teorikisht mbështetjen në tabanin kombëtar. Tek ndonjëri ka koncepte vlerësonjëse nihiliste për artistët pararendës.

Në masën e talenteve të reja sidomos, i kemi të paktë piktorët dhe skulptorët që i njohin traditat tona të krijuara dhe vlerat e traditës së larmishme popullore. Të paktë janë ata (në tërë masën e piktorëve dhe skulptorëve), që kanë dashuri e konservojnë objekte të bukurisë popullore - tha ndërmjet të tjerash Dhimitër S. Shuteriqi.

Nuk evidentojnë sa duhet, objektivisht sukseset e artit tonë socialist. Nuk shkruajnë për sukseset e punimeve të kolegëve tanë, të artit tonë, duke ndjekur hap pas hapi vazhden e tërë krijimtarisë sonë artistike si dhe çdo krijonjëse në veçanti. Nga ndjenja dhe mendime të



shprehura saktë, paralel me praktikën artistike, për të bukurinë tonë, do të kuptohej dhe do të luftohej kotësia e çdo ndikimi të ndonjëri i ri apo krijonjëse më përvojë. Disa nga këto ndikime - tha ndonjë shok, vinë nga një fakt i thjeshtë që Partia gjithmonë na e ka vënë në dukje nga lidhja e pamjafveshme e gjithmonë aktive e artistit qytetar me jetën e gjallë të vëndit. Kur nuk merr mësim nga jeta, atëherë hap detyrimisht libra të çfardoshëme dhe gjn "inspirim" në to sepse edhe mbivlersimi i fantazisë në përballon dot mungesën e frymëzimit dhe ushqimit nga jeta.

Gjatë praktikës sonë artistike - tha Thoma Thoma - disa punime duken sikur frymëzohen nga njëra tjetra dhe jo nga jeta. Kjo pruri një ngjashmëri në disa skulptorë në ekspozitat tona e sidomos në lëvizje psikologjike etj. Ndonjëherë janë shmëbla imitimesh nga skulptura sovjetike. ("Revolucioni marshon" e Shaban Hadërit, "Revolucioni marshon" e Thanas Papës, "Lart frymën revolucionare" e Muntaz Dhramit etj.) Duke përfutur nga arti revolucionar sovjetik para revolucionist, piktura dhe skulptura jonë u përpoqën ta bëjnë këtë në frymën dhe tabanin kombëtar, por imitimet e ndikimit direkt e demtonojnë originalitetin e veprave tona.

Duke vënë re punën e pamjafveshme dhe mësenjëherë të dobët të organeve tona letrare-artistike, del nevoja e një reviste të ilustruar 2-3 mujore, që do të përmbledh e trajtojte sistematikisht tërë sferën e praktikës dhe problemet ideostetike të arteve figurative.

Ksenofon Dilo

VENDIMI I QEVERISË/ Kriteret dhe dokumentacioni që duhet të plotësoni, ja sa është masa

Pagesa e papunësisë, ja sa muaj e përfitoni në bazë të kontributeve të derdhura

"Ndërprerja e të ardhurave, rastet kur mund të penalizoheni"



Voltiza Duro

Këshilli i Ministrave ka miratuar ditën e djeshme programin mbi pagesën që kanë mundësi të marrin të gjithë personat e papunë që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligj. "Përfitojnë të ardhura nga papunësia të gjithë personat e siguruar, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 53, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.", theksohet në vendimin e qeverisë. Përfituesit do të kenë mundësinë të marrin 50% të pagës minimale në shkallë vendi, në rastin kur plotësojnë kriteret e iu miratohet kjo e ardhur. Ndërkaq, në vendim bëhet me dije se personat që ndërpresin aktivitetin si punëdhënës dhe të vetëpunësuar; largohen nga puna me dëshirën e tyre; apo plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar, paaftësi të përkohshme në punë apo sëmundje profesionale, nuk mund të përfitojnë të ardhura nga papunësia.

PAGESA SIPAS KONTRIBUTEVE

Individët, të cilët plotësojnë kushtet e përcaktuara, u paguhet e ardhura e pagesës së papunësisë në varësi të periudhës së kontributit në sigurimet shoqërore. Kështu e përfitojnë 3 muaj pagesën të gjithë të papunët që kanë një periudhë kontributi, të paktën 1 vit si dhe 6 muaj personat me një periudhë kontributi të paktën 3 vjet. Ndërkohë individët që kanë një periudhë kontributive minimale 5 vjet, mund të përfitojnë nga pagesa e papunësisë për 9 muaj, e ata që kanë mbi 10 vjet kontribute e marrin këtë pagesë për plot 1 vit. "Personat gra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç dhe burra mbi 60 vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar 1 (një) vit në sigurimet shoqërore, për çdo rast përfitimi. Për rastet e paraqitjes së kërkesave të përsëritura për përfitim, llogaritja e periudhës së kontributeve fillon me përfitimin e fundit të pagesës të të ardhurave nga papunësia", nënvizohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Ndërkaq, në këtë të fundit theksohet se individët, të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, duhet të paraqesin dokumentacionin përkatës, i cili përfshin një kërkesë për aplikim; librezën e punës; një dokument identiteti (fotokopje);

si dhe një vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, dhe për personat që ndjekin arsimin të lartë apo janë të paafte (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç.



Foto ilustruese

DOKUMENTACIONI

Personat, të cilët aplikojnë për të përfituar të ardhura nga papunësia, duhet të paraqesin dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- Kërkesë për aplikim;
- Librezë pune;
- Dokument identiteti (fotokopje);
- Vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, dhe për personat që ndjekin arsimin e lartë apo janë të paafte (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç.

si dhe një vërtetim për ndjekjen e arsimit të mesëm, për fëmijët në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, dhe për personat që ndjekin arsimin

PENALIZIMI

Në vendim theksohet se nëse nuk njoftojnë brenda këtij afati për rastet e sipërpërmendura, atëherë përfituesit duhet të kthejnë shumën e të ardhurave që kanë marrë në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.

e lartë apo janë të paafte (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç. Ndërkohë, vetë zyrat e punësimit duhet të sigurojnë për secilin aplikues një certifikatë të gjendjes familjare; vërtetim nga dega e tatim-taksave se personi nuk është subjekt i regjistruar pranë këtyre organeve; si dhe një vërtetim nga dega e tatim-taksave ose e sigurimeve shoqërore se personi ka derdhur kontribute për periudhën e kërkuar.

NDËRPRERJA E PAGESËS

Të gjithë personave përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia u ndërpritet përfitimi kur refuzojnë të punësohen ose të ndjekin një program punësimi të përshtatshëm, të ofruar nga zyra e punësimit; apo refuzojnë të marrin

pjesë në kurse trajnimi dhe kualifikimi, të ofruara nga zyra e punësimit. Gjithashtu, kjo pagesë papunësie ndërpritet edhe kur përfituesit nuk paraqiten një herë në muaj; apo nuk plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar. Është detyra e përfituesit që të njoftojë brenda 5 ditëve në zyrën përkatëse në rastet kur gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, ky individ punësohet apo vetëpunësohet; apo ka ndryshime në gjendjen familjare (lindje apo vdekje). Gjithashtu, personi duhet të njoftojë edhe në rastet kur personat që kanë ngarkim të tij kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe ata që studiojnë apo janë të paafte (KMCAP) kanë mbushur moshën 25

PAGESA E PAPANËSISË SIPAS KONTRIBUTEVE:

- 3 (tre) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 1 (një) vit;
- 6 (gjashtë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën, 3 (tre) vjet;
- 9 (nëntë) muaj, për personat me një periudhë kontributi, të paktën 5 (pesë) vjet;
- 12 (dymbëdhjetë) muaj, për personat me një periudhë kontributi mbi 10 (dhjetë) vjet;
- Personat gra mbi 55 (pesëdhjetë e pesë) vjeç dhe burra mbi 60 (gjashtëdhjetë) vjeç përfitojnë pagesë papunësie 12 (dymbëdhjetë) muaj, me kusht që të kenë kontribuar 1 (një) vit në sigurimet shoqërore, për çdo rast përfitimi.

Nuk përfitojnë të ardhura nga papunësia personat, të cilët:

- ndërpresin aktivitetin si punëdhënës dhe të vetëpunësuar;
- largohen nga puna me dëshirën e tyre;
- plotësojnë kriteret për pension pleqërie, invaliditeti apo familjar, paaftësi të përkohshme në punë apo sëmundje profesionale.

vjeç. Në vendim theksohet se nëse nuk njoftojnë brenda këtij afati për rastet e sipërpërmendura, atëherë përfituesit duhet të kthejnë shumën e të ardhurave që kanë marrë në mënyrë të padrejtë, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore.

MASA E PAGESËS

Personat, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e së ardhurës nga papunësia, kanë të drejtë të marrin të ardhura shtesë familjare mbi masën e nivelit bazë, në masën 5% të të ardhurave nga papunësia, për çdo fëmijë në ngarkim, deri në moshën 18 vjeç, si dhe për personat që janë duke vazhduar studimet ose janë të paafte (KMCAP), deri në moshën 25 vjeç. Shtesa familjare për çdo fëmijë, në masën 5% të nivelit bazë, nuk duhet të jetë më shumë

se 30%. Fëmijët mbi moshën 15 vjeç (mosha minimale sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë), të cilët janë në ngarkim të personit përfitues të së ardhurës nga papunësia dhe që nuk janë të përfshirë në sistemin arsimor, nuk do të përfitojnë shtesën familjare prej 5%. Në rastet kur prindërit janë të divorcuar me vendim gjykatë, shtesën familjare e merr prindi që ka fëmijën në ngarkim, e në rastet e punësimit të përkohshëm gjatë periudhës së përfitimit të pagesës të së ardhurës nga papunësia, e ardhura e papunësisë merret me ndërprerje. Periudha, gjatë së cilës përfituesi merr pagesën e së ardhurës nga papunësia, njihet si vjetërsi pune, e siguruar për efekt pensioni pleqërie, familjar dhe invaliditeti.



Vendimi i qeverisë: Ja sa do të jetë masa e përfitimit

Pagesë për pjesëmarrjen në kurset profesionale

Të gjithë ata punëkërkuës të papunë, që marrin pjesë në një kurs të formimit profesional mund të përfitojnë një pagesë pjesëmarrjeje në kurs. Ky është vendimi i marrë ditën e djeshme nga Këshilli i Ministrave ku u miratua që masa e kësaj

pagesë të jetë 50% e të ardhurës nga papunësia, me kusht që ata të mos përfitojnë gjatë kësaj periudhe ndihmën ekonomike ose pagesën e papunësisë. Kjo pagesë do të jepet për ndjekjen vetëm të një kursi, gjatë gjithë kohëzgjatjes së

tij e punëkërkuësit e papunë mund të përfitojnë vetëm një herë nga ky program. "Në zyrën e punësimit ngrihet komisioni i vlerësimit, i përbërë nga, të paktën, tre persona, i cili vlerëson rast pas rasti punëkërkuësit të cilët do të marrin këtë pagesë, si

pas kriterëve të përcaktuar në rregulloren përkatëse, të përcaktuar në pikën 11, të këtij vendimi.", theksohet në vendim. Ndërkaq, pagesa do të kryhet nga zyra përkatëse e punësimit, pas dërgimit të një konfirmimi nga institucioni ofrues i kursit që pjesëmarrja në programin e formimit profesional është e rregullt. Kjo nisim do të fillojë të zbatohet gjatë vitit 2018 dhe kohëzgjatja e saj do të jetë 5 vjet.

Shëndetësi

Hithra në gjethet e saj ka disa çimza të vogla, të cilat nëse i prek këputen nga bima mëmë e futen në lëkurën e personit që i ka prekur. Tre përbërësit kimikë të saj që janë histamina, afetinkolina dhe steronina, fillojnë që të japin efektin djegës në organizëm, **pra këta elementë hyjnë në qarkullimin e gjakut dhe e nxisin këtë të fundit.**



Voltiza Duro

Mjeku popullore: Përdorimi i saj siguron më tepër jetëgjatësi e shëndet për njeriun

YLLI MERJA: Hithra, mbretëresha e bimëve mjekësore në Shqipëri

"Luftuesja e artritit reumatoid, anemisë e alergjive"

Hithra, një bimë me të vërtetë e magjishme ka një përhapje pothuajse mbarë botërore dhe në të gjitha trevat edhe në vendin tonë, duke përfshirë që nga zonat bregdetare deri në lartësitë mbi 1000-1200 metra mbi nivelin e detit. Në Shqipëri hithra mund të gjendet në vendet gëlqerore dhe gurishtore e në shumë raste mjafton që pak fara të hithrës të hidhni në themelet e shtëpisë dhe shumë shpejt do kuptoni që keni mbjellë një bimë që do i shërbejë me së shumti jetëgjatësi dhe shëndetit tuaj. Hithra në gjethet e saj ka disa çimza të vogla, të cilat nëse i prek këputen nga bima mëmë e futen në lëkurën e personit që i ka prekur. Tre përbërësit kimikë të saj që janë histamina, afetinkolina dhe steronina, fillojnë që të japin efektin djegës në organizëm, pra këta elementë hyjnë në qarkullimin e gjakut dhe e nxisin këtë të fundit. Por, nëse do vëmë re që këto përbërës kanë një efekt djegës në organizëm jo për një kohë shumë të gjatë, duhet të kuptojmë se pse hithrat djegin për shumë orë, por jo me të njëjtin fuqi vepruese në organizëm. Kjo veçori e bimës ka lidhje me faktin që në brendësi të këtij lëngu që ka depërtuar tashtë në trupin e njeriut, nuk ka të bëjë vetëm me përbërësit e mësipërm, por vlen të përmendet pjesa që në brendësi të saj ka edhe acidët sarrarikë dhe oskallikë. Këta lloj acidesh zgjasin efektin veprues të tre lëndëve përbërëse të hithrës në organizëm, pra zgjasin djegien. Shpeshherë njerëzit kur padashur "digjen" nga hithra, mundohen që ta shpëllajnë atë me ujë, por në këtë mënyrë vetëm e shtojnë efektin djegës të hithrës. Nëse duam të minimizojmë këtë efekt, atëherë shpëllarja nuk duhet të kryhet me ujë, por me sodë buke, e cila shërben si një neutralizues shumë i



Mjeku popullore Vlliri Merja

mirë në këtë rast. Pra, një sodë me përqendrim të lartë, zvogëlon dhe minimizon efektin djegës të acidit sarrarik dhe oskallik mbi lëkurë.

EFKTTET KURUESE

Prej mijëra vjetësh, praktikuesit e mjekësisë bimore kanë rekomanduar që hithra të përdoret për kurimin e sëmundjeve të ndryshme, siç janë ato të artritit reumatoid, anemisë, sëmundjet e alergjive, problemet urinare (pengesat në urinim, djegjet gjatë urinimit). Gjithashtu, kjo bimë ka efekte çudibërëse edhe në trajtimin e ekzemave të ndryshme, pickimet nga insektet mushkonjave si dhe në kurimin e dhimbjeve muskulore. Mendojmë që përbërësit aktivë biologjikë

që ndodhen te hithra, si flavonoidet, që kanë veti anti-

oksiduese, e kjo ndihmon në largimin e radikaleve të lira

nga trupi i njeriut. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që trupi të jetë më i qetë dhe i gjithë organizmi në tërësi të veprojnë ndaj ngacmuesve të jashtëm si një i tërë. Për sa i përket problemeve alergjike, konsumimi i çajit të hithrës, ndihmon në parandalimin e alergjive të ndryshme sezonale ose përmirëson simptomat e tilla si teshtitja, kruarjet, lotimi i syve etj. Pacientët që janë trajtuar me bimën e hithrës, të kombinuar me bimë të tjera mjekësore, kanë pasur efekte shumë të mira kurative në drejtim të alergjenëve të ndryshëm. Mendojmë se këta të fundit që depërtojnë në organizmin e njeriut dhe shkaktojnë këto çrregullime dëmtohen nga hithra pasi përbërësit e saj depërtojnë shumë lehtë në mem-

branat qelizore dhe në ADN-në e këtyre viruseve apo baktereve që shkaktojnë alergjinë. Përfitimet e hithrës mund të shikohen edhe në pengimin e zhvillimit të baktereve në sistemin urinar. Falë përvojës shumëvjeçare është vënë re se njerëzit që kanë pasur pengesat në urinim, e pas konsumimit të supës me lakra e hithra brenda në të, kanë vënë re se është shtuar shumë diureza. Pra, nëse një ditë më parë urinimin me vështirësi, konsumimi i hithrës, ka bërë që shpeshherë të kenë ndjesinë e urinimit, i cili ka qenë i lirshëm. Pas disa konstatimeve të tilla, arriti që të përhapje opinionin se hithra me të vërtetë ka një efekt shumë të mirë çlirues gjatë urinimit. Flavonoidet që ndodhen në gjethet e hithrës, ndihmojnë të nxisin epitelin renal të hithrës për prodhimin e urinës dhe largimin e kripërave të tepërta nga organizmi e njëkohësisht zgjerojnë sistemin urinar. Hithra ndihmon edhe në luftimin e hipertrofisë prostatike malinje, e në rastet kur problemet të meshkujt vijnë nga enjtja e prostatës, nga edema e saj, hithra jep rezultate shumë të mira për mirëfunksionimin e prostatës. Pra, hulumtimet klinike mbështesin faktin që gjethet e hithrës janë shumë të dobishme për lehtësimin e simptomave BHP, pra hipertrofisë prostatike.



Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 përfituesit

ATP: Dosjet e vitit 1996, pronarët që kompensohen

Ish-pronarët, aplikimet e ezauruara

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 4900 pronarë, të cilëve u është njohur drejta për kompensim. Dosjet i përkasin vitit 1996. Lista me vlerësimin përfundimtar për subjekte është botuar në faqen zyrtare të Agjencisë së Trajtimit të Pronave. Lista përmban të dhëna lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, mangësitë në dokumentacion apo vlerësimin përkatës jepen të detajuara në regjistrin që shqëron këtë njoftim. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit si dhe vlerësimin financiar për çdo dosje.

KOMPENSIMI FINANCIAR

Bazuar në skemën që po ndjek qeveria në zbatim të ligjit të ri për pronat, prioritet do të ketë prona truall, përkundër tokave bujqësore, që do të jepen për kompensim fizik. Pas shqyrtimit të

kërkesave, kompensimi financiar bëhet vetëm për ato subjekte, vendimi i të cilëve është përfundimtar, i ekzekutueshëm ose për kërkesat që nuk janë trajtuar asnjëherë për kompensim. Të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall, do të përfitojnë kompensim financiar nga fondet e kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë. Ndërkohë, pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar do të kompensohet fizikisht nga fondet e tokës. Në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e mbetur është deri në 5 për qind me



e madhe se vlera 50 milionë lekë, atëherë subjekti kompensohet për të gjithë vlerën, në rastet kur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar rezultojnë se pjesa e

mbetur është më e madhe se 5 për qind mbi vlerën 50 milionë lekë, atëherë subjekti për diferencën mbi 50 milionë lekë, kompensohet fizikisht, nga fondet e tokës.

KOMPENSIMI FIZIK

Agjencia e Pronës ka në zotërim 23 mijë hektarë tokë bujqësore, për të cilat ka përfunduar më herët edhe vlerësimi ekonomik, të cilat do të përdoren për skemën e kompensimit fizik. Për ndarjen e kësaj sipërfaqjeje, dy do të jenë kriteret bazë. Kriteri i parë është rendi kronologjik i vendimeve, që do të thotë se, sikurse kompensimi financiar, edhe ky kompensim do të fillojë me vendimet më të vjetra në kohë. Kriteri i dytë lidhet me vendndodhjen e pronës që do të përfitojnë si kompensim fizik. Pra, pronari do të kompensohet me një pronë nga fondet

fizik, e cila gjeografikisht është më afër me pronën që i është njohur për kompensim. Në lidhje me dokumentet që duhet të depozitohen, ato nuk ndryshojnë, por mbeten të njëjta, si në rastin e kompensimit financiar. Ndryshon vetëm formulari i aplikimit, i cili është specifik për secilin rast. Në total janë 26 mijë vendime të formës së prerë, të cilat presin të kompensohen. Bazuar në ligjin e ri, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka nisur një proces të ri rivlerësimi, ku një metër katror tokë do të llogaritet me çmimet e tregut, por zëri kastral nuk do të jetë ky i sotmi, por ai që ka pasur pronë në çastin e shpronësimit.

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

(Vijon nga numri i djeshëm)

Korçë	Thomaq Terezi			1,880,000
Korçë	Alo Kabashi			231,040
Korçë	Sulejman Istref			561,000
Korçë	Abaz Fazo			
Korçë	Fiqirije Shkembii			454,330
Kukës	Iljaz Thaci			
Kukës	Hysen Gjoni			
Kukës	Jonuz Muca			
Shkodër	Terezina Hajmeli			
Shkodër	Berhan Nikshiqi			1,894,565
Shkodër	Beqir Mackiqi			
Tiranë	SHEQER ELEZI			EZAURUAR
Tiranë	IDAJET FARKA			EZAURUAR
Tiranë	HYSEN SHALQIZI			EZAURUAR
Tiranë	XHAVIT BODINAKU			
Tiranë	ADRIAN SERETI			
Tiranë	GANI TAKU			610,160
Tiranë	XHEMAL SHKAMI (SHKEMBI)			432,484
Tiranë	SHABAN LICHI			EZAURUAR
Tiranë	RAKIP VORPSI			
Vlorë	Seit Xhaxhiu			11,682,000
Gjirokastër	Selim Gaba			217,296
Gjirokastër	Begzane Ajazi			391,221
Lezhë	Gjergj Ndue Ndoj			
Lezhë	Nikolle Bal Marku			
Shkodër	Muhamet Qehaja			1,412,826
Tiranë	REXHEP BALLA			EZAURUAR
Tiranë	DALIP SINA			EZAURUAR
Vlorë	Mazik Cumani			352,000
Vlorë	Xhemal Zeqo			176,000
Vlorë	Luan Leka			EZAURUAR
Vlorë	Remzi Dalani			EZAURUAR
Vlorë	Mehmet Plaku			EZAURUAR
Vlorë	Hader Musai			45,000
Vlorë	Beko Feimi			52,500

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Vlorë	Bardhyl Laze			57,320
Vlorë	Miho vito			
Lezhë	Preg Llesh Rahmani			105,499
Vlorë	Nesim Roboçi			280
Gjirokastër	Memo Kamber Pazaj			583,168
Gjirokastër	Myslim Haredin Xhezo			616,869
Gjirokastër	Qemal Demir Dervishaj			479,365
Gjirokastër	Hajri Ibrahim Kapaj			931,613
Gjirokastër	Xhemil Kociu			1,084,826
Gjirokastër	Naze Kociu			272,975
Korçë	Gaqo Bimbli			EZAURUAR
Korçë	Dhimitër Furxhi			
Korçë	Nikolla Blushi			
Durrës	Luan Lila			5,210,160
Durrës	Fiqirete Gorani			
Durrës	Ymer Levonja			
Durrës	Emerjeta Çullhaj			
Durrës	Daut Tereziu			
Durrës	Haki Ballhysa			
Durrës	Hiqnet Agolli			3,053,336
Durrës	Ndue Prenga			374,819
Durrës	Dhurata Belegu			80,220
Durrës				80,220
Gjirokastër	Cerciz Myftari			628,520
Gjirokastër	Cane Matuka			730,803
Gjirokastër				290,804
Korçë	Kristaq Palo			
Korçë				
Korçë	Jovan Mihal Vako			1,154,010
Shkodër	Lutfi Laqja			
Shkodër	Jonuz Dibra			2,346,816
Shkodër	Besnik Çelcipija			4,153,368
Shkodër	Ali Laqja			
Shkodër	Ali Laqja			
Shkodër	Hysni Hasani			EZAURUAR
Tiranë	SHYQYRI, RASIM RROJI			
Vlorë	Avdul Ismaili			

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	Mbimëri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
-------	-------------------------	--------	----------------------------	-----------

Vlorë	Thodhori Driza			
Vlorë	Ali Laçaj			
Gjirokastër	Shahin Lamce Pasha			315,803
Gjirokastër	Latif Zilfo Deraj			417,950
Berat	Kadri Laze			1,263,420
Berat	FATRI SEVRAMI			302,502
Berat	Flamur Meço			1,374,023
Berat	Flamur Meço			
Berat	Muharrem Meço			6,627,639
Berat	Kujtim Zaimi			606,186
Berat	Shaban Ismaili			9,559
Dibër	NAZMIE CEMURATI			
Gjirokastër	Menekshe Faslli Sadikaj			492,145
Gjirokastër	Sinan Skendi			379,499
Korçë	Petraq Vangjeli			1,486,688
Korçë	Dhimitraq Kristollari			1,071,993
Korçë	Teqija Qesarakë			2,269,061
Korçë	Hekuran Mehmet			490,574
Korçë	Muharrem Metko			4,744,207
Dibër	AHMET BAJRAM AHMETI			
Dibër	GJERGJ RICA			
Korçë	Orhan Baçellari			39,703
Dibër	XHEMAL SHQARTHII			
Lezhë	Nikoll Preng Gjoci			
Tiranë	MUSA DEMNERI			19,822,824
Tiranë	TEFIK VORPSI			21,128,720
Dibër	Rustem Pepa			
Korçë	Uran Butka			1,871,261
Korçë	Neim Rusi			18,000
Berat	Hekuran Lulaj			1,483,680
Elbasan	BESNIK MUZHAQI			8,472,920
Elbasan	FATMIR SHEFIK SUPARAKU			
Elbasan	XHELADIN MEHJA			
Lezhë	Kol Mark Vokrri			
Tiranë	Eqerem Sheshi			2,362,225
Tiranë	GJENOVEFA KOSTRISTA (LUSHA)			3,485,250
Tiranë	SEMIHA SHYRBA			

(Vijon nesër)

Në garë tri forcat politike, ja cilët janë pjesëmarrësit Zgjedhjet presidenciale në Mal të Zi, shtatë kandidatë garojnë për drejtimin e vendit

Në zgjedhjet presidenciale që do të mbahen në Mal të Zi, më 15 prill, do të garojnë sipas të gjitha gjasave shtatë kandidatë. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve ka miratuar deri të martën kandidaturat për president të Malit të Zi nga tri forca politike. Ndërkohë që ka paralajmëruar pjesëmarrjen në zgjedhjet presidenciale edhe kandidati opozitar, i cili mbështetet nga pjesa më e madhe e partive të opozitës, përfshirë

MILLO GJUKANOVIÇ

"Vendimi im është shprehje e përgjegjësisë ndaj asaj çfarë janë detyrimet dhe të arriturat e Malit të Zi. Orientimi im personal ka qenë ndryshe, por kur merreni me punën me të cilën unë merrem për më shumë se një çerek shekulli, atëherë keni detyrime partiake, personale dhe shoqërore", - tha Gjukanoviç.

Frontin Demokratik, Demokratët e Malit të Zi, Partinë Popullore Socialiste dhe Lëvizjen Qytetare URA. Kandidati i Partisë Demokratike të Socialistëve

për President të Malit të Zi do të jetë kryetari i saj Millo Gjukanoviç, i cili edhe më herët në një mandat ka qenë kryetar i Malit të Zi. "Vendimi im është shprehje e

përgjegjësisë ndaj asaj çfarë janë detyrimet dhe të arriturat e Malit të Zi. Orientimi im personal ka qenë ndryshe, por kur merreni me punën me të cilën unë merrem për më shumë se një çerek shekulli, atëherë keni detyrime partiake, personale dhe shoqërore", -tha Gjukanoviç, pas mbledhjes së Këshillit Qendror të PDS-së. Propozimet e kandidatëve për kryetar të Malit të Zi i dorëzohen Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve deri më 26 mars 2018. Presidenti



i Malit të Zi zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, me mandat pesëvjeçar. Këto janë zgjedhjet e shtata presidenciale gjatë sistemit shumëpartiak

në Mal të Zi, që nga viti 1990. President i Malit të Zi nga viti 2003 është Filip Vujanoviç, i cili këtë funksion e ka ushtruar për tre mandate radhazi.

Ndërpritet seanca, Delawie: I zhgënjyer, s'është sjellje e shtetit evropian

Gaz lotsjellës për demarkacionin, miratohet në darkë në Kuvend

Deputeti që hodhi gazin: E kisha detyrim

Kuvendi i Kosovës mbajti dje seancën ku pritej të votohej projektligji për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi. Seanca u shoqërua me debat dhe tensione, ndërsa deputetët e Vetëvendosjes kanë hedhur gaz lotsjellës dhe seanca është ndërprerë disa herë. Për të tretën herë në Kuvendin e Kosovës, Lëvizja Vetëvendosje ka gjuajtur me gaz lotsjellës në sallë. Edhe më herët, deputetët e partisë së Albin Kurtit, gjuajtën gazin lotsjellës, ndërsa disa prej tyre janë përjashtuar. Pas hedhjes së gazit lotsjellës seanca është ndërprerë sërish. Ndërkohë që prokurori kujdestar i Prokurorisë Themelore të Prishtinës ka dhënë urdhër për arrestimin e deputetëve që kanë hedhur gaz lotsjellës në Kuvendin e Kosovës ku pritej të miratohej edhe demarkacioni. Pas urdhrat, policia e Kosovës filloi arrestimet e deputetëve të Vetëvendosjes në sallën e Kuvendit. Ndërkohë kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli ka bërë të ditur se edhe Kryesia ka marrë vendim për përjashtimin e pesë deputetëve të Kosovës. Bëhet fjalë për deputetët: Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Salih Zyba, Liburn Aliu. Të njëjtit gjuajtën dy herë radhazi gaz lotsjellës në momentin kur pritej të dilte në votim Marrëveshja. Kuvendi i Kosovës ka ndërprerë dy herë seancën e Kuvendit, në të cilën parashihej që të votohej marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi. Por, nga ana tjetër, hedhja e gazit lotsjellës në Kuvend ka sjellë shumë reageime nga të huajt që e ndoqën seancën e djeshme. Sipas ambasadorit amerikan në Prishtinë, Greg Delawie, kjo nuk është sjellje e një shteti evropian. Ai ka qenë duke ndjekur nga afër punimet e Kuvendit të Kosovës për ratifikimin e demarkacionit, por është



AMBASADORI AMERIKAN NË PRISHTINË GREG DELAWIE

"Më duhet të them se sot ishte një zhgënjim i madh për mua, sepse mendoj që njerëzit, të cilët nuk kanë kurrfarë ideje dhe idetë e të cilëve kanë bankrotuar, i kthehen dhunës. Kjo nuk guxon të ndodhë në shtet evropian. Hedhja e gazit lotsjellës nuk është sjellje evropiane" tha Delawie.



DEPUTETI QË HODHI GAZIN, XHELAL SVEÇLA

"Është obligim i yni të përcjellim dhe të pasqyrojmë vullnetin e mbi 205.000 nënshkrimeve kundër faljes së tokës. Është obligim edhe ndaj të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes!", -ka shkruar Sveçla në "Facebook".

shprehur i zhgënjyer me aktin e deputetëve opozitarë të Lëvizjes Vetëvendosje që kanë hedhur gaz lotsjellës në Kuvend për të ndërprerë votimin për ratifikimin e Marrëveshjes së demarkacionit të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi. "Më duhet të them se sot ishte një zhgënjim i madh për mua,

sepse mendoj që njerëzit, të cilët nuk kanë kurrfarë ideje dhe idetë e të cilëve kanë bankrotuar, i kthehen dhunës", tha Delawie. "Kjo nuk guxon të ndodhë në një shtet evropian. Hedhja e gazit lotsjellës nuk është sjellje evropiane", theksoi ai. "Do t'i ftojta të gjithë deputetët të kthehen në Kuvend

dhe të votojnë për ratifikimin e demarkacionit dhe të votojnë për rrugën evropiane dhe përparimin e Kosovës", -tha ambasadori amerikan. Kosova ka mbetur e lidhur për një kohë të gjatë me këtë çështje dhe se ajo duhet të mbyllet sot, ka porsitur ai. Për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend nga

Lëvizja Vetëvendosje, ka reaguar edhe komisioneri evropian për zgjerim, Johannes Hahn. "E dënoj fuqishëm përdorimin e gazit lotsjellës. Një sjellje e tillë nuk ka vend në demokraci. Në këtë ditë të rëndësishme, liderët kosovarë duhet të jenë të përgjegjshëm dhe ta votojnë marrëveshjen e demarkacionit. Qytetarët e tyre vetëm mund të përfitojnë nga kjo hap drejt liberalizimit të vizave", -ka thënë Hahn. Nuk ka munguar as reagimi i deputetit të Vetëvendosjes, Xhelal Sveçla, i cili së bashku me deputetën Fitore Pacolli hodhën gaz lotsjellës në seancën e Kuvendit të Kosovës. Ai me anë të një statusi në "Facebook" është shprehur: "Është obligim i yni të përcjellim dhe të pasqyrojmë vullnetin e mbi 205.000 nënshkrimeve kundër faljes së tokës. Është obligim edhe ndaj të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes!", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ndërsa presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka quajtur pamje të tmerrshme të Kosovës në botë hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend. "Dhuna në Kuvend është e patolerueshme dhe pamje e tmerrshme për Kosovën në botë. I ftoj deputetët që të vazhdojnë me punën e tyre, pavarësisht taktikave të rrezikshme të kundërshtarëve të liberalizimit të vizave. Demarkacioni duhet të kalojë sot. Kjo është ajo që presin qytetarët e vendit, pa dallim partie apo etnie", shkruan ndër të tjera Thaçi.

SHKURT

Lirohen 100 vajzat e rrëmbyera në Nigeri

Rreth 100 nxënëse që ishin rrëmbyer në qytetin nigerian, Dapchi, muajin e kaluar, janë kthyer në shtëpi. Sipas Reuters, vajzat janë lënë të lira, pasi u rrëmbyen nga militantët e grupit terrorist Boko Haram. Numri i saktë i vajzave të kthyera ende nuk është përcaktuar. Ushtria e Nigerisë ka hedhur poshtë një raport të Amnesty International, ku pohej se forcat e sigurisë ishin paralajmëruar disa herë përpara rrëmbimit të nxënësve.

Uruan fitoren e Putinit, kritikohen presidentët Trump e Juncker

Donald Trump e Jean-Claude Juncker janë vënë me shtatulla pas muri nga politikanët perëndimorë pasi uruan presidentin rus Vladimir Putin për fitoren në zgjedhjet presidenciale. Kritikant ndaj dy liderëve erdhën pasi marrëdhëniet mes Perëndimit dhe Rusisë morën një goditje të fortë me debimin nga Londra dhe Moskë të diplomave respektivë nga vendet e tyre, pas helmimit të ish-agjentit rus, Sergei Skripal dhe vajzës së tij.

KRITIKA

“Makbethi” në teatër një ëndërr e keqe, pse aktorët ngjanin si kukulla

Josif Papagjoni

“Nuk është plagjiat, por ofshamat m'u dukën të tepërta”


Pata disa ngasje për ta parë tragjedinë e tmerruar dhe, ndoshta, sipas kritikës, më e bukura dhe më e përpunuara letrarishit për nga forma e stili: “Makbethi” i Shekspir-it në Teatrin Kombëtar. Teatri shqiptar i është qasur jo rrallë gjenit duke prekur sipërinë e tij. “Hamleti” ka qenë një nga kulmet dhe lavditë e shijuara me regjisorin rus Bortko dhe tre asistentë shqiptarë, pastaj qe “Otello” (regjisor rusi Kriçko), “Mbreti Lir” (regjisor Pandi Stillu) dhe në fillim të viteve '90 erdhi “Rikardi i tretë”, regjisor Agim Qirjaqi. Tri të parat, pra “Hamleti”, “Otello” dhe “Mbreti Lir”, tok me “Makbethin” që, po t'i bindemi hierarkisë që ka ndërthur mendimi kritik botëror vjen fill pas “Hamletit” për nga përkryerja artistike, janë katërshja më e mirë e asaj çka ka arritur gjenia shekspiriane. I duhej, pra, një “Makbeth” Teatrit Kombëtar. Ngasja e dytë për mua ishte vetë vepra me gjithë gravitetin e saj thuajse “shtypës”, për çdo regjisor e aktor. Është një sfill, ankth e frikë, po aq dridhërimë e pasion. Çfarë të “reje” do të thuash, si do ta thuash, a do të mbërrish në sipërinë e veprës, a do ta prekësh tmerrin dhe madhësinë e saj apo do të qëndrosh në syprinë, të cipa farfuritëse? Ky është një gur themeli që s'mund t'i shmangesh dot, qofsh një Piter Bruk apo qofsh një regjisor i ri shqiptar. Dhe ngasja e tretë e imja, siç kuptohet, ishte koncepti regjisorial, çfarë qasjeje të re, befasesue, madje sfiduese, do të sillte ai?!

Është fare e lehtë ta rrëzosh çdo punë kur ajo barabitet me legjendat e dramës dhe teatrit në botë. Por jo! Kjo është rruga më e lehtë dhe, madje, ajo më e pandershmeja për një kritik, ku bëzan, qoftë dhe hesh-turazi, një mendjemadhësi e papërligjuri në atë çka është dhe çka përfaqëson teatri ynë. Unë e ndoqa me kureshtje dhe interes shfaqjen. Kisha një ftesë nga regjisor i saj, ish-student im, Kledi Kapexhiu, i biri i ish-pedagogut tim, Bujar Kapexhiut, dhe shkova, pra me kënaqësi. Më erdhi vërtet mirë që Kledi sollë një imazh dhe trajtë tjetërfarë të veprës. Të tijën. Kjo më mbresoi. Ai i kishte ikur enkas çdo formë a paraqitjeje, le ta quajmë realiste apo “natyrale”, ku gjasja mes asaj që na jepet nga përfytyrimi rreth personazhit si dhe inter-pretimin të tij prej aktorit, respekt-jo përputhshmëri mundësisht maksimale midis tyre, qoftë dhe kur modeli jetësor, paçka se i transformuar gjegjësisht ligjësisve të teatrit, bëhet krijës i konceptit regjisorial. Jo. Kledi i kishte bisht-

nuar enkas kësaj, e kishte refuzuar shëmbëllimin realist. I kishte ikur klišeive. Ai kishte krijuar një kod tjetër sjelljeje të aktorëve në rolet e tyre. Si të thuash, i kishte ikur “mimesisit”, pra përngjashmërisë së veprimit aktorial me modelin e pranueshëm jetësor, natyral. Kish-te shkuar prej andej dhe kishte aplikuar një mënyrë dukshëm të diferencuar me këtë model, përputhur tashmë një paraftyrimi “ndryshe”, tjetërfarë, që e pohet drejt postmodernizmit.

Sipas meje ai kishte gërshtetur disa kahe. Më së pari, koncepti i tij regjisorial i ishte qasur formave paraqitje të teatrit antik grek, çka u shfaq jo thjesht te make-up me gropat e syve, gojët e hapura si klithma e gjëma, blanat në fytyrë, herë të zeza e mavi e herë të kuqe, sipas roleve, sipas vuajtjes së hequr, bë-mave dhe akteve që ata kryenin. Skematizimi i lëvizjes të conte veti drejt shfrytëzimit të modelit që vjen, më së shumti, nga teatri i kukullave. Kjo u pa gjithandaj, në ecjen e aktorëve, të lëvizja e duarve apo të objekteve (thikës etj.), në hapat dhe zhvendosjen e trupit, njëjtë me atë të marionetave të manipuluar, çka, në syrin tim, u mbërrit mjaft bukur nga Indrit Çobani, që luante Makbethin, me tundjet e lehta të supeve e të kokës, me buzëqeshjen, por dhe nga aktorë të tjerë si Luli Bitri, Neritan Liçaj, Genti Deçka, Xhino Musollari. Po pse u pëlqye ky trajtim? A mos ndoshta është menduar se historia përplot tmerr e kësaj tragjedia shkruar mbi 400 vjet më parë ka nevojë të kundrohet si një ëndërr e keqe a si një përrallë fëmijësh me “gogolë” e “ujqër”, që trembin e shqyjnë njerëz, sikundër qe në fakt edhe tirania e Makbethit? Një ëndërra shpesh ngjajnë kësaj shpërfytyrimesh e shpërndër-rimesh, kur lëvizja ngrin, skematizohet, kur imazhi kthehet përmbys ose kur trajtat njerëzore natyrale përftojnë sipri një vesk a cipë surreale, tjetërllor, çudane, paradoksale, të frikshme. Mund të jetë kësh-tu, por kjo për mua nuk është fort e rëndësishme. E rëndësishme është a pëlqehet, a krijon tryzni psikike të spektatori me qëllim që t'i gje-gjet tmerrit që vepra përmban? Kureshtar siç isha dhe më përvojën që kam, përpos që e ndiqa me vëmendje veprimin skenik, vija re se publiku nuk pati asnjë lloj ngasjeje për të “qeshur” nga veprimi kinse kukullor e paradoksal i aktorëve. Dhe pikërisht kjo ishte, do të thosha, triumfi i regjisorit, i cili, edhe pse përmes një forme të përçudnuar, të skematizuar dhe, ta quajmë kukullorë të sjelljes së ak-

torëve, krijoi në sallë tension, sus-pansë. Heshitja zotëronte gjithkund. Kodi regjisorial u kuptua qysh në kryeherë. Spektatori e mori të mirëqenë atë dhe e respektoi gjer në fund. Kjo ishte pikërisht trajta moderne e teatrit dhe e mënyrës së një leximi të ri regjisorial. Shi për këtë unë do doja ta çmoja e ta nxis-ja Kledin, që t'i ngjitet kësaj udhe edhe më me guxim, duke qenë i bindur për fare se forma që ai na paraqiti ishte e suksesshme dhe e lavdërueshme. Dikush, qoftë dhe në mendjeshkrepte a hamendje, mund të thotë se një formë e tillë është plagjiat, unë diku e kam parë të kjo apo ajo shfaqje etj. Unë e refuzoj një gjykim e mendësi të tillë. Në jemi brenda një hapësire stilistike botërore dhe duhet të përftojmë prej mejeve të reja shprehëse që teatri ka krijuar falë gjeniumit të reformatorëve të tij. Unë vura re një begati detajesh e pjellori fantazie të regjia e Kled Kapexhiut, e cila der-dhej e njëmendësoj gjithkund. Unë po kujtoj vetëm disa gjetje që kish-in mbivendosje të qarta kuptimore, pra një notacion apo, le ta quajmë metatekst regjisorial, të për-punuar bukur mirë. Qysh në fillim shfaqja nuk me daljen prej territ dhe vdekjes (perdes së zezë) të fig-urës së Makbethit, veshur me kos-tum të kuq - ngjyra e gjakut dhe e krimit. Domethënë, në sjellim një histori të vjetër, futur në dheun e zi, për t'ju kujtuar të dashur miq që na keni ardhur sot në teatër se ajo, historia ngjethëse e Makbethit kos-cep nuk është përfundimisht e “gro-posur” në harresat e historisë, por mund të gjeni sivilëzërit tuaj në mjediset ku jetoni, paçka se forma dhe imazhi janë tjetërllor, jo si ky i yni. Ky i “yni” është një gjasë dhe personazh teatri, ndërsa ai i juaj ka tjetër trajtë, është brenda jush, e keni në një tavolinë pune a banket social shtetëror, jo siç e shprehim ne, përmes një perdeje të zezë, ten-dosja nga dy anët, Makbethi dhe zonja Makbeth. Vrasjet në shfaqjen tonë nuk bëhen tinëz, në terr, por haptazi, me kamat që godasin mes dritës së fortë, që përsëriten dhe që, madje, duken si në një “lojë” fëm-jijësh... Tri magjistratë nuk janë tri plaka shtriga, me fytyrat e shëmtua plot zhubra, por tri balerina, tri çupa të bukura, gati si kukulla, top-modele, që të kujtojnë personazhet e teatrit japonez “No” apo ato të teatrit kinez “Kabuki”, ku luhet den-dur me simbolikat, shenjat dhe for-mat denaturale të lëvizjes, gjestit, fjalës, të kthyer në rit, në këngë, në vokaliza, në “opera”. Mëotri çupa bukurshme janë tri Moirat e sotme të fatit, shtetgjar prej mitit grek dhe rishëmbëllimit shekspiri-



an të magjistratëve, në tri pamje të tjera, që mua, sikundër thashë, më afrojnë me modelimet e teatrit të Lindjes. Dhe bri këtyre tri magjistratëve, ja ku shëtit skenës edhe hija e veshur në të zezë e Vdekjes, ose Hekata, që përveç një funksioni spastrimi të trupave të vdekur nga skena (p.sh. vdekja e mbretit Dulkan, e Bankos, e zonjës Makdaf dhe Fleancit), kryen edhe një funksion estetik regjisorial për të shmangur makabritetin dhe praninë e vrasjeve, që i shkojnë më shumë imazhit filmik se sa atij teatror, prandaj dhe skematizohen si të tillat falë konvencionit plastik duke u përpunuar përkatësisht kodeve të rrepta teatrorë.

Regjisor i kishte përdorur si element ankthi ofshamën, te thuajse gjithë personazhet që bënin apo pësonin krime, tmerr, vrasje. Ofs-han Makbethi, Dunkani, Makdafi, Banko etj. Ofshama bëhet në mënyrë ritmike, e kombinuar me hapin. Është diç e përpunuar dhe teatrale në thell, duke na kujtuar kësodore se gjendemi mes tmerrit, frikës, ankthit, vrasjeve, paranojës, gjumit të prishur, ëndrrave të frik-shme. Por mu duk paksa e tepërar, e përsëritur vend e pa vend, ndofta mund të qe më pak e pranishme dhe jo me domosdo në çdo cast e në çdo personazh.

Unë do doja të diskutoja fare pak edhe me artikullimin e mesazhit regjisorial, ku ndër të tjera thuhet se: “Në një vend ku të gjithë janë vrasës dhe të gjithë viktimat pranojnë të vriten, ai beson se askush nuk mund të vihet mes tij dhe push-tetit”. E nënvizova enkas fjalinë, për

të thënë se vepra nuk e ka diç të tillë, por, sipas meje, as vetë koncepti regjisorial, aq sa pashë, nuk e kishte të nënvizuar me “laps të kuq” viktimizimin e njerëzve, pamundësinë për t'i dalë krimin ballë për ballë. Në e pamë se “pylli i Brinjës i ra malit të Duskinjës”. Nëse kjo ishte profecia që Makbethi besonte te pushteti i tij absolut si një casubelli, pra një paranojë, përkundraz, shpata e Makdafi, ku qe mblodhur jo vetëm urrejtja e tij me familjen e shfarosur prej Makbethit, por edhe përбетimi i fisnikërisë skoceze, i krejt popullit, tregojnë pikërisht të kundërtën se viktimat nuk pranojnë më të vriten prej tiranit. Për ta rrëzuar pushtetin tiranik të ng-ritur mbi rrëmbimin e kurorës legjitime, përmes vrasjes së mbretit dhe një morie krimesh, ky akt, kjo sim-bolikë - vrasja e Makbethit dhe beteja për ta rrëzuar pushtetin e krim-it janë vetë theli i tragjedisë. Është drita që hidhet, një zgjidhje që Shekspiri e pat dhënë në gjithë tragjeditë e tij, të cilat, edhe pse mbylleen me vdekje e tmerr, nuk e humbasin fillin e rivendosjes së të drejtës, reparacionin, kthimin e leg-jalitëtit. Në ofshamë se leximi regjisorial i Kledi Kapexhiut rrekejt ta bënte këtë një lëndë sunduese në kon-ceptimin e lëndës së veprës letrare, për ta përshtratur, ndofta, me le-targjinë e shoqërisë sonë ndaj sjell-jes shpesh të duhshme të kastës së korruptuar politike shqiptare në raport me shoqërinë dhe mungesën e reaktivit të kësaj të fundit, kjo do të kërkonte, sipas meje, të tjera shenja regjisoriale, shumë më të rrokshme dhe më të lex- →

PIKTORI

Fatmira Nikolli

Iri, në të 20-at kur ishte student në Romë, fundjavave a në kohë pushimesh, Vangjushi merrte trenin për në Venecia, ku ulej përballë gondolave, në sheshin "San Marco", përballë "Palazzo Ducale", në urën e "Rialtos", në urën e "Psh-erëtimave", në "Grande Canale", përballë "La Fenices" dhe vizatonte, pikturonte, bënte skica. Rreket të fiksonte mbi letra a mbi beze, sa më shumë detaje të qytetit magjik. Ai vetë, e quante qytet ëndërr, ndaj ndonëse me mundësi të pakta ekonomike, i riu nga Korça, kursente që të udhëtonte drejt Venecias. Dashuronte rrugicat prej ku shihte qiellin të puthej me ujën, dyqanet e maskave, shitoret "Muranos". Vangjush Mio dashuronte ndërtesat ngjyra-ngjyra, kishëzat e kapelat, rrugicat, kthinat, galeritë, kopshtet e Bienales e jo vetëm. Pikturoi kudo dhe kur u kthye në fund të studimeve, ai solli në Shqipëri, Venecian e penelit të tij.

Pothuaj 100 vite më pas, Vangjush Mio rikthehet atje. Është e Bija Rozeta Mio, që ka bërë të pamundurën prej muajit dhjetor që i ati, të rikthehej në Venecia. Mio, nuk është më. Veprat që ka lënë, e morën udhën e kthimit për në qytetin ku lindën dhe u vunë përballë. Venecia e 100 viteve më parë, me Venecian e sotme.

Në 16 mars, u çel ekspozita "Omaggio a Vangjush Mio", kurrar nga Vladimír Myrtezaí dhe Migena Hajdari.

Ekspozita u parapri nga një Vendimi i Këshillit të Ministrave që lejonte "lëvizjen jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të 11 veprave të Piktorit të Popullit Vangjush Mio, me qëllim ekspozimin e tyre në Centro Culturale Don Ori- one Artigianelli, Sala Tiziano, Dorsoduro 909/a në Venecia, Itali".

E BIJA PËR TË ATIN

Ekspozita e parë e Mios, që hapur në shtëpinë e jetimores, me punimet e sjella nga Bukureshti. Mësuesi i vizatimit dhe mësuesi i historisë së artit në Liceun Francez, më 1921 do të hapte studion e tij si pikturor. Deri më 1924-ën, kreu studimet në Akademinë e Arteve të Bukura në Romë dhe fitoi dy diploma për pikturë dhe restaurim. Dy vite më pas, do të ndiqte Bienalen e Venecias. Kur më shumë se 9 dekada më vonë, rikthehet në Venecia me veprat e realizuara në atë kohë, është e Bija, Rozeta Mio që flet në emër të tij.

"Babai më thoshte se Venecia është një qytet ëndërr. E donte gjithë Italinë, donte muzikën e artin, por për Venecian, kishte një dobësi të veçantë". Në anën tjetër të telefonit me një të folme prej Korçës, Rozeta Mio, më flet nga galeria ku ka çelur ekspozitën në Centro Culturale Don Ori- one Artigianelli, Sala Tiziano, Dorsoduro 909/a.

Një prej kuratoreve, Migena Hajdari thotë se galeria ndodhet në një zonë ku shumë pikturorë italiane kanë pikturuar dhe ekspozuar. "Është një zonë shumë e mirë. Çelja e ekspozitës ka qenë një nisim e Rozeta Mios që nga muaji dhjetor. Dontë të rikthente të atin në Venecia dhe meqë kam një galeri në Padova, kërkoi ndihmën time. Ekspozita u realizua me ndihmën e Vladimír Myrtezaít. Ekspozita është pritur mirë nga media dhe nga publiku", -tha Hajdari.



VEPRAT E VANGJUSH MIOS NË VENECIA

E bija: Babai i thoshte qyteti ëndërr, kam harxhuar shumë para...

"Rozeta Mio: E bëra ekspozitën me forcat e mia, shpresoj të shitet ndonjë vepër t'i shlyej..."



Vetë Rozeta, tërhequr siç është, tha për "GSH" se hapja e kësaj ekspozite këtu është shumë e madhe. "Për mua është një gjë e madhe dhe shumë domethënëse. Jam shumë e lumtur që u hap më në fund.

E solla babain këtu, sepse kisha shumë dëshirë dhe me ndihmën e Migenës ia dola". Kur e pyes, se çfarë i thoshte i ati për Venecian, Rozeta përgjigjet menjëherë: "E quante qytet ëndërr; thoshte është qytet i mrekullueshëm".

Mandej flasim me Rozeta Mion, për kohën kur i ka realizuar. "Disa i ka realizuar kur ishte student. Është gjitha punimet që janë në Venecia, i ka punuar kur ka qenë në Institutin e Lartë të Arteve në Romë, në moment kur kishte pushime, realizonte piktura. Atëkohë studentët nga ana ekonomike ishin shumë të varfër, se kishin kushte shumë të dobëta, por im atë kursente dhe vinte në Venecia e shkente edhe në qytete të tjera e pikturonte. Më shumë piktura ka me Venecian, e jo vetëm vizatime me laps e karbon, por edhe shumë piktura me vlerë".

Për Rozetën rikthimi i të atit në qytetin ëndërr, është pothuaj një ëndërr. Uron që ekspozita të ketë sukses, edhe pse në ditë e para



kur është çelur, shikuesit kanë qenë të shumtë dhe po ashtu media e kanë ndjekur me shumë interes, duke vlerësuar artin e Mios. E pyes Rozetën, nëse ekspozita "ju ka kushtuar shumë nga ana financiare?". Ajo përgjigjet menjëherë: "Sigurisht edhe nuk i kam shlyer të gjitha. Të gjitha i kam bërë vetë me forcat e mia. Të shohim tani. Kam shpresë të shes ndonjë pikturë që të mund të plotësojmë shpenzimet. E bëra, sepse babai e vlerësonte shumë artin e muzikën italiane e këtë na e ka mësuar edhe në fëmijëve në shpirt. Është një vend i mrekullueshëm thoshte, vend i artit e muzikës më thoshte gjithmonë. Pastaj për

Venecian kishte një dobësi të veçantë. Qytet i mrekullueshëm. Është një ëndërr".

MIO, NJERIU DHE PIKTORI

Mio Vangjush Mio (Korçë 1891- Tiranë 1957) filloi të vizatojë që fëmijë, por veprat e tij të ruajtura në koleksionin e familjes i përkasin vitit 1906. Ai vlerësohet si një nga piktoret e parë profesionistë në Shqipëri.

Fillimisht Mio priret të bëjë vizatime me laps dhe sepia, duke realizuar portrete, figura, kompozime, nudo dhe peizazhe. Më pas realizoi kompozime nga jeta e përditshme e njerëzve të thjeshtë, portrete familjare dhe portrete të ndryshëm, duke u dashuruar mbas peizazhit urban, baritor, liqeneve dhe detit. Ai vizatoi dhe pikturoi peizazhet e disa zonave të Shqipërisë, kala, site arkeologjike, pamje qytetesh në Romë, Venecia, Bolonjë, Piza, Firenze, Durrës, Butrint, Ulqin, Tiranë, Shën Naum, Tiranë, Durrës, Vlorë, Sarandë, Pogradec, Shkodër, Përmet, Gjirokastrë e Berat. Krijimtaria e gjerë e artistit Vangjush Mio në fushën e peizazhit dhe portretit realist, u bë shkollë e madhe për të gjithë artistët shqiptarë, pasi ai realizoi vepra me kualitet të lartë artistik, evidenti dritën diellore mesdhetare të peizazhit shqiptar dhe u bë shembulli brilant i piktorit të natyrës. Mio krijoi imazhin e figurës së piktorit në Shqipëri, që i ofron publikut veprat e tij në ekspozita vetjake dhe në studio. Shumë pikturë të njohur që kaluan fëmijërinë në qytetin e Korçës, morën mësimet e para në pikturë nga mjeshtri Vangjush Mio.

Vepriartaria artistike e Vangjush Mios është shumë e gjerë. Ai ka lënë një koleksion të madh veprash në gjininë e portretit, peizazhit e më pak kompozime. Numërohen mbi 500 tablo të tij, 200 vizatime, si dhe 80 pllaka xhami fotografike, të cilat ruhen në studion Muze të pikturit (Korçë), në GKA, Tiranë, në GA, Korçë dhe në koleksionet e institucioneve të larta shtetërore dhe në koleksionet private.

← ueshme nga publiku. Besoj se ky është më shumë një lapsus retorik, se sa mesazhi i njëmendtë regjisorial.

Dy nga elementët me shprehësi dhe identitet në shfaqje genë edhe skenografia e Genc Shkodranit dhe muzika e trajtimit zanor i Bled Borakut. I pari pruri një hapësirë burgu, mure të fortë si nëpër kështjella, thellësi, boshësi pa mobilje dhe fare-fare pak rekuizitë, çka krijonte zymtimin e domosdoshëm, ndërsa i dyti ofroi një medium zanor vërtet të frikshëm, mbushur me tinguj, ofshame, klithma, akorde, vokalica sopranosh, zhurma, që të gjitha së toku, në mendimin tim, konvergjuan mjaft mirë me tragjedinë. Nga kostumet e punuara prej Ger- ta Oparakut më të goditura mu dukën kostumi i Makbethit, ai i tri magjistrave (si këngëtare soprano a balerina), i zonjës Makbeth, i Hekatës, por do doja më shumë identitet në kostumet e tjera si ai i mbretit Dulkan, i Makdafit, Ros- it, gjer dhe Bankos etj.

Paçka se stili i lojës krijonte një farë "njësimi" te aktorët dhe është e vështirë të dallosh njerin nga tjetri, gjithsesi më la mbresë aktimi i Indrit Çobanit në rolin e Makbethit, që e mbajti në një tension të rreptë e të vijueshëm vep- rimin, sidomos me përgendrimin e vëmendjes, syrin e ndezur dhe gjithë elementët përplotësues; më tutje më tërhoqi loja e Luli Bitrit të zonja Makbeth, Genti Deçka të Bankoja, Adelina Muça të zonja Makdaf (pak fjalë, por me ashk) dhe Xhino Musollari të vrasësi.

Opinion *i* Ditës

Andi Bushati

(Vijon nga faqja e parë)

... një turi të kësaj fillim jave, për t'ia mbushur mendjen autoriteteve të BE që t'i hapin dritën jeshile Shqipërisë, ai ka thënë një numër të vërtetash që, të gjitha së bashku, krijojnë një imazh të gënjeshtërt.

Le t'i marrim me radhë... Ai ka përsëritur tezën e vjetër se është në interesin e BE që Ballkani Perëndimor të mos jetë "këndi i lojërave të ndonjë fuqie tjetër". Ai ka bërë apel që politikanët e kontinentit plak nuk duhet të bien pre e ideologjisë të forcave nacionaliste që luajnë me frikën e zgjerimit.

Ai ka ridikulizuar shqetësimin për lidhjet e politikës me krimin e organizuar, duke lënë përshtypjen se steriotipi i një vendi që e ka të keqen në ADN-në e vet, duhet përbuzur.

Ai madje ka shkuar edhe më tej, duke nënvizuar politikën e dy standardeve, që dikur pranoi bullgarët (populli që plagosi papa Vojtilën) dhe rumunët (që i mbushën bulevardet e Europës me prostituta), ndërsa sot përdor të tjera kritere për gjashtëshen që mëton të anëtarësohet.

Ai nuk ka pranuar faktin se ka vende që janë përpara Shqipërisë në garën e anëtarësimit duke hedhur dorashkën e sfidës se me problemet që ka me Kosovën, Serbia nuk do të mbërrijë kurrë në Bruksel përpara nesh.

Ai e ka quajtur tashmë një dëshirë që ne ia përbushëm Europës, e cila e kërkoj me ngulm reformën në drejtësi dhe se ata nuk kanë më arsye tjetër për të na mbajtur peng.

Po t'i shohësh një e nga një të gjitha argumentet që kryeministri shqiptar ka renditur në intervistën për Politico.eu, janë të vërteta (lexo linkun poshtë).

Rama hap sfidën: Ne do t'i lëmë mbrapa serbët në garën për në BE

Në Europë fryma ksenofobe, si rezultat i suksesit të partive populiste, po rritet; rreziku që kjo pjesë e Ballkanit të bëhet pre e forcave anti-perëndimore po shtohet; frika nga zgjerimi është po aq e fortë sa dhe stereotipet që gëlojnë për popullsitë tona.

Të gjithë këta faktorë, që nuk varen nga ajo, janë pengesë reale për përparimin normal të Shqipërisë drejt Brukselit.

Por, pranuar këtë, duhet thënë gjithashtu se kjo është vetëm njëra anë e medaljes.

Fakti se në Europë na paragjykojnë, nuk e fsheh dot realitetin e lidhjes së politikës me krimin dhe mbushjes së parlamentit me banditë.

Fakti se "nuk e kemi krimin në

Fytyra e Ramës në pasqyrën e Brukselit



ADN", nuk e mohan dot se gjatë qeverisjes së rilindjes tonelatit e narkotikëve që i çojmë Europës janë situar.

Fakti se kemi votuar Reformën në Drejtësi nuk e mbulon dot "largimin në drejtim të paditur" të gjitha kokave të policisë që drejtonin skemën kriminale të kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Fakti që Serbia ka probleme të rënda me Kosovën nuk e zhbën dot prapambetjen tonë në përbushmentin e detyrimeve.

Fakti se dikur BE ka pranuar

rumunët dhe bullgarët, nuk na jep në të drejtë të kërkojmë të bëjë të njëjtat lëshime.

Në këtë kuptim, duke thënë të vërteta të thjeshta dhe të ditura për atë që çalon në kontinentin e vjetër, Rama mëton të fshehtë përgjegjësitë e tij si kryeministër i një vendi që kërkon të bëhet anëtar i ri. Ai nuk është në rolin e një mendimtari të lirë, apo të një intelektual vizionar që ka për qëllim të tregojë se si bëhet më e mirë BE. Fatkeqësisht për të, ai është në petkun e përfaqësuesit të

një vendi të vogël dhe me probleme, që duhet të jetë i pranueshëm për të trokitur aty.

Duke veshur rrobat plot lara dhe ngjyra të të parit, ai refuzon të mbajë kostumin e ngushtë të atij që më shumë se me të drejtën për të imagjinuar, shkon në Bruksel me detyrimin për të raportuar.

Dhe duke përmbytur këtë ekuacion ai e dëmtton vendin e tij. Sepse ai nxjerr përpara Europës një fytyrë që shtrembëron realitetin, për të cilën ajo nuk ka shumë nevojë.

Lapsi.al

HOROSKOPI

DASHI

Këtë ditë do të ndiheni të sigurt nga një ndjenjë praktike dhe nga largpamësia në investime dhe në projekte. Keni dëshirë të jetoni në thellësi të shpirtit tuaj, atë që deri më tani e keni jetuar në nivel të mendjes. Jepini, mos humbni kohë.

DEMI

Parashikohen ndryshime. Për momentin, mos merrni vendime të prera, që mund të mos jenë më pak të duhurat. Pritni sa të qartësohen gjërat. Mos bini pre e tundimit për të reaguar menjëherë, sidomos në punë. Rrezikoheni nga shpërqendrimet.

BINJAKET

Do të keni prije për t'u mbyllur brenda vetes për të rremuar në të kaluarën. Por do të merrni në konsideratë edhe mundësinë e së tashmes. Kontakti me persona të veçantë do t'ju hapë horizonte të reja dhe do t'ju japë mundësinë të përmirësimit.

GAFORJA

Mos u gënjeni nga shkëlqimi një momenti pasioni që bën që t'ju rrahë fort zemra, sepse mund të dalë se është krejt ndryshe nga sa dukej. Bashkëveprimi i planetëve në shenjën tuaj, bën që keni pak dëshirë të angazhoheni. Përpiquni të jeni më i gatshëm.

LUANI

Dita e sotme do të jetë disi e vështirë, me shumë keqkuptime, ankesa dhe mendime jo shumë optimiste. Sot në dashuri do të jeni pak jashtë ritmi. Megjithatë nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, por ndërkaq dëshira për t'u larguar nuk e favorizon mirëkuptimin.

VIRGJERESHA

Nëse është krijuar pak tension me partnerin, mos e lëni çështjen pa e sqaruar me hollësi. Për të kthyer harmoninë do të jetë më e thjeshtë sesa mendoni! Përfitoni nga mbështetja që ju garanton familja, për të përbushur zgjedhjet që do të bëni.

PESHORJA

Do të përballemi me një zgjedhje të rëndësishme, qëndrojeni zgjedhjeve të bëra më parë dhe mos hiqni dorë nga autonomia e tuaj. Mos i lejoni një familjari t'ju pengojë. Do t'ia dilni të angazhoni në nisat tuaja, duke prekur pikat e duhura emocionale.

AKREPI

Përpiquni të jeni më të dashur, pasi ju bën veçse mirë. Padyshim, do të lehtësonte ndeshëm raportet me personin që keni në krah. Mos e harroni! Ndërrytja e një familjari në punët tuaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

SHIGJETARI

Në familje do të keni disa kundërshtime të shkakta nga këndvështrimet e ndryshme. Mos u mbyllni pasi larmishmëria është gjithmonë diçka pozitive, që duhet shfrytëzuar për t'u ngritur. Falënderoni miqtë, që ju rrinë pranë duke ju dhënë ide dhe mundësi të mira.

BRICJAPI

Sot nuk është dita për të bërë beteja kundër mullinjve të erës. Prandaj mos e çoni ndër mend se mund të ndryshoni botën! Si zakonist, mbi të gjitha për çështje pune, reagoni duke u mbështetur mbi vendosmërinë dhe saktësinë.

UJORI

Jeni të detyruar të merrni me çështje praktike të mërzitshme dhe kjo do t'ju prishë humorin. Nëse një nga propozimet tuaja bie ndesh me ndonjë pengesë, mos u dekurajoni. Mos u zbrapsni nga rrethana pak të përshtatshme dhe thoni gjithmonë atë që mendoni.

PESHQIT

Shmangni marrjen e angazhimeve për të cilat jeni të sigurt se nuk do të mund t'i çoni deri në fund. Duhet të mësoni të thoni jo, kur është e nevojshme. Për shkak të Plutonit që ju kundërshton, parashikohen disa vonime në udhëtime si edhe keqkuptime në punë.

BLUE TOOTH
THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA

te rejat nga jeta ipave

çdo të shtunë falas me

Dje në 'Deutsche Welle'

Nga Bekim Shehu

Demarkacioni, një fitore e vështirë

(Vijon nga faqja e parë)

... i Kosovës e ratifikoi marrëveshjen e shënimit të kufirit me Malin e Zi. Në këtë mënyrë i jepet fund një teme tre vjeçare, debatet rreth së cilës ndër vitet e fundit u shogëruan edhe me akte të dhunshme, brenda seancave dhe jashtë seancave në rrugët e Prishtinës. Për t'u siguruar numri prej 80 votave sa duhet për t'u arritur dy të tretat e votave, koalicionit qeverisës u desh edhe një votë nga lista Srpska dhe votën pro e dha Adem Hoxha, deputet i pacicës gorane në subjektin politik lista Srpska.

VETËVENDOSJA KUNDËR

Nëntë deputetët e tjerë serbë nuk morën pjesë në seancë. Ratifikimi i demarkacionit me Malin e Zi, është njëri nga kushtet e fundit për liberalizimin e vizave për Kosovën. Sapo ligji i demarkacionit duhet të hidhet në votim, deputetët e Vetëvendosjes hodhën gazin lotsjellës.

Njëra nga deputetët e Vetëvendosjes, Albulena Haxhiu, e arsyeve të hedhjen e gazit lotsjellës në seancën e Kuvendit për ta penguar votimin e demarkacionit, me Malin e Zi se Kosova humb territor. "Me veprimet tona ne po i shpëtojmë deputetët e tjerë nga akti i tradhtisë që po i bëjnë Kosovës. Ne jemi të bindur se Kosova humb territor. Mund të duket si jo normale situata e krijuar në Kuvend, por edhe para tre viteve kemi vepruar njësoj dhe për shkak të rezistencës kjo çështje nuk ka kaluar", -u shpreh Albulena Haxhiu.

REAGIME TË PREZENCËS NËNDËRKOMBËTARE NË KOSOVË

I menjëhershëm ishte reagimi i ambasadorit amerikan në Kosovë, Greg Delawie nga ambientet e Kuvendit, i cili tha se dhuna si mjet politik nuk ka vend në Kosovë. "Dita e sotme ishte zhgënjim për mua, njerëzit që s'kanë ide, i kthehen dhunës politike për të përmbytur qëllimet e tyre, kjo nuk duhet të ndodhë në Kosovë, sepse Kosova është më shumë se kaq. Kjo nuk duhet të ndodhë në një shtet evropian. Kam respekt për të gjithë deputetët që me mjete demokratike po provojnë të arrijnë qëllimin e tyre, kalimin e demarkacionit me Malin e Zi, prandaj i nxis ata që ta votojnë marrëveshjen e demarkacionit", -u shpreh ambasadori Greg Delawie.

Hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend e dënoi edhe ambasadori gjerman në Kosovë, Christian Heldt. "Kjo s'mund të shërbejë si një shembull i mënyrës për të luftuar për ide dhe politikë në forumin më të lartë politik në vend", - shkroi ambasadori Heldt.

E tronditur me zhvillimet në Kuvendin e Kosovës u shpreh edhe shefja e zyrës së BE-së në Kosovë, Natalya Apostolova. "Ngjarjet që ndodhën në Kuvendin e Kosovës nuk janë popullore. Unë jam e shokuar çfarë ndodhi në Kuvend. Hedhja e gazit lotsjellës në parlament në vendin ku duhet të zhvillohet debat, është kundër principeve të BE-së dhe kjo e sjell Kosovën para në zhvillimin e saj demokratik.

Unë përgëzoj deputetët që morën guximin për t'u kthyer në seancë dhe ta votojnë demarkacionin", -tha Natalya Apostolova.

THAÇI: KEMI HUMBUR TRE VJET

Edhe Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e dënoi dhunën e shfaqur nga Vetëvendosja në Kuvendin e Kosovës dhe hedhjen e gazit lotsjellës presidenti e cilësoi "si një pamje të pa tolerueshme dhe të

tmerrshme për Kosovën në botë".

"Votimi i demarkacionit nënkupton lëvizje të lirë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Mjaft kemi humbur tre vjet me kauza të rrejshme, që po mbajnë Kosovën dhe qytetarët të izoluar. Tani është momenti i së vërtetës dhe i veprimit. Vendimi i deputetëve pro ratifikimit të marrëveshjes është vullnet i qytetarëve që duan t'i përqafojnë vlerat evropiane. Mos

lejoni që të sfidoheni nga askush, sidomos jo nga ata që duan ta mbajnë Kosovën larg vlerave evropiane dhe të izoluar", -shkroi në profilin e tij social Presidenti Hashim Thaçi.

Nuk vonoi shumë dhe për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend reagoi edhe Komisioneri Evropian për Zgjerim, Johannes Hahn. "E dënoj fuqishëm përdorimin e gazit lotsjellës. Një sjellje e tillë nuk ka vend në demokraci. Në këtë ditë të rëndësishme, liderët kosovarë duhet të jenë të përgjegjshëm dhe ta votojnë marrëveshjen e demarkacionit. Qytetarët e tyre vetëm mund të përfitojnë nga kjo hap drejt liberalizimit të vizave", -shkroi në profilin e tij Johannes Hahn.

REAGIMI I LISTËS SRPSKA

Kundërshtimin e tyre kundër demarkacionit e kanë shprehur hapur Lista Srpska, Lëvizja Vetëvendosja dhe grupi i deputetëve të pavarur të ndarë në kjo parti që gjithsej së bashku bëjnë 42 deputet. Glauk Konjufca shef i grupit parlamentar të Vetëvendosjes, tha se "kjo parti është e bindur se Kosova humb territor me marrëveshjen e vitit 2015 të nënshkruar ndërmjet qytetarëve të Kosovës dhe asaj të Malit të Zi". Vetëvendosja duke manifestuar kundërshtimin e saj fillimisht, i dorëzoi në tavolinë kryeministrit Haradinaj, shumë dosje me një peticionin të nënshkruar dy vjet më parë nga shumë qytetar që janë shprehur kundër ratifikimit të demarkacionit me Malin e Zi. Këtë peticion e kishte mbështetur në atë kohë edhe partia e zotit Haradinaj, (AAK) që ishte në opozitë.

Deputetët e listës Srpska nuk kanë marrë pjesë në asnjë seancë rreth çështjes së demarkacionit duke kundërshtuar kështu dhe duke mos u interesuar për ratifikimin e shënimit të kufirit me Malin e Zi. Ata më herët janë deklaruar se atyre u intereson më shumë krijimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe, sesa, demarkacioni me Malin e Zi.

Marrëveshja për demarkacionin me Malin e Zi e nënshkruar në vitin 2015 është plotësuar edhe me një aneks-marrëveshje ndërmjet dy presidentëve, atij të Kosovës Hashim Thaçi dhe të Malit të Zi Filip Vujanović. Në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet dy presidentëve, thuhet se pas ratifikimit të demarkacionit në Kuvendin e Kosovës, të dy vendet do ta rishikojnë vijën kufitare dhe do të bëhen korrigjime nëse ka pasur lëshime. Kuvendi i Kosovës ka kohë që e ka ratifikuar marrëveshjen e demarkacionit me Kosovën.



BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT MË VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB
NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE
PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE
APPLE DHE ANDROID





Juristët e klubit korçar argumentojnë për pafajësinë Skënderbeu dorëzohet në UEFA, sytë nga KAS

Skënderbeu ka njoftuar zyrtarisht se është zhvilluar seanca dëgjimore në Komisionin e Kontrollit, Etikës dhe Disiplinës të UEFA-s, lidhur me procedimin disiplinor ndaj klubit korçar. Në këtë seancë kanë qenë të pranishëm përfaqësuesit tanë ligjorë, të cilët kanë ar-

gumentuar mospërfshirjen dhe pafajësinë e plotë të klubit në veprimtaritë e pretenduara nga Inspektorët e Disiplinës të UEFA-s. Klubi bardhekuq deklaron se ka besim të strategjia e ndjekur nga ana e përfaqësuesve të tij ligjorë, teksa frytet e vërteta pret t'i arrijë vetëm në

Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Lozanë, pasi paralajmëron tifozët dhe opinionin se dënimi nga UEFA është i pashmangshëm. Kjo pasi sipas klubit korçar duhet marrë në konsideratë natyra e konfliktit, specifika që paraqet gjykimi disiplinor në organet juridike të UEFA-s

dhe veçanërisht, ekzistencën e një marrëdhënie institucionale ndërmjet organit të akuzës dhe të gjykitimit. Skënderbeu, nëpërmjet komunikatës, dëshiron të sqarojë sportdashësit dhe opinionin publik se procesi gjyqësor për çështjen në fjalë është në fazën fillestare të tij dhe se Klubi i Futbollit Skënderbeu është i gatshëm të mbrojë investimet dhe punën disave vjeçarë në të gjitha shkallët e gjykitimit, qofshin ato sportive apo civile.

Lojtari i Skënderbeut rrëfen se ka refuzuar Kosovën, ai i Luftëtarit kërkon minuta



Jeton Selimi

Abazaj e Gavazaj presin mundësinë e tyre

Dy talentet të nderuar nga grumbullimi

Si rrallë herë, pjesë e ekipit përfaqësues janë disa elemente shumë cilësore nga Superliga Shqiptare. Kur sheh në Kombëtares futbollistë si Kristal Abazaj dhe Enis Gavazaj sigurisht që të lë një shijë të mirë, dy lojtarë ofensivë, të cilët luajnë bukur me topin, lojtarë triblues dhe mbi të gjitha lojtarë të rij dhe me prespektivë për të ardhmen. Përveç talentit, Abazaj dhe Enis Gavazaj kanë një tjetër emërues të përbashkët, dëshirën për të veshur fanellën kuqezi, një ëndërr e bërë realitet, dhe arritja e tyre me e madhe në karrierë.

"Unë kam qenë pjesë e Shpresës dhe e prisja ftesën, por kur e morëm vesh që erdhi për kombëtaren A ishte një ndjenjë e papërshtueshme. Ndihehem shumë i vlerësuar", deklaroi Abazaj në konferencën e djeshme për shtyp. "Kishim emociione, sepse ishte grumbullimi i parë në Kombëtaren A. Një ndjenjë e papërshtueshme. Ishte një dhuratë

e bukur, është arritja më e madhe imja. Duhet të japim maksimumin dhe të jemi sa më afër ekipit, duhet të bëjmë punën tonë. Trajneri vendos nëse do të luajmë. Atmosfera është shumë e mirë, kam disa shokë nga e kaluara", shtoi Enis Gavazaj nga ana e tij. Gavazaj mund të kishte një tjetër të ardhme nëse nuk do të ishte dëshira e tij e madhe për të përfaqësuar Shqipërinë pasi më herët në drejtim të talentit të Skënderbeut ka ardhur ftesë nga përfaqësuesja e Kosovës. "Kam pasur 2-3 herë ftesë nga Kosova, por unë e kisha vendosur për të luajtur me Shqipërinë. Kam zgjedhur ngjyrat kuqezi dhe këtë e kam bërë më dëshirën time të plotë", rrëfen sulmuesi i Skënderbeut.

Konkurrenca në rolin që luajnë dy futbollistët e Su-



perligës është e madhe, por e rëndësishme për momentin është që janë pjesë e Kombëtares A. "Konkurrenca bën mirë në çdo skuadër, të impenjon. E rëndësishme është që jemi këtu. Lojtarët që luajnë jashtë Shqipërisë

ndoshta kanë një ritëm më të lartë, por s'mund të them se kanë ndonjë avantazh tjetër. Nuk kemi biseduar me trajnerin, por e dimë se çfarë kërkon Panuçi. Seanca e parë ishte më shumë për t'u njohur me ekipin. Ne u munduam të jepnim 100%", flet anësori që po shkëlqen me Luftëtarin në Superligë. "Ne duhet të tregojmë veten në Kombëtare pastaj të shohim nëse do të transferohemi në ndonjë kampionat më të rëndësishëm. Edhe të Skënderbeu do të jemi mire", përfundon Gavazaj.

SEANCA E DYTË



Kuqezinjtë përveshin mëngët, Panuçi do qarkullim topi

Kohët për takime dhe përhëndetje kanë përfunduar. Në grumbullimin e Kombëtares së Shqipërisë për miqësoren e 26 marsit kundër Norvegjisë ritmi i përgatitjeve është rritur ndjeshëm. Nga dita e djeshme ka nisur programi me dy seanca stërvitore, tekta pas asaj të paradites futbollistët kuqezi nën drejtimin e Kristian Panuçit zbritën sërisht në fushën stërvitore. Për herë të parë, skuadra ka qenë e plotë, megjithëse Etrit Berisha ka vijuar përgatitjet e diferencuar. Portieri është paraqitur në grumbullimin e kombëtares me një dëmtim muskolor, por me shumë mundësi do të rikuperohet për sfidën e ardhshme. Ndërkohë, me grupin janë bashkuar edhe dy mbrojtësit që kishin marrë leje nga Panuçi. Berat Gjimshiti u grumbullua me një ditë vonë, pasi për arsye familjare kishte udhëtuar drejt Gjakovës. Edhe Elseid Hysaj është bashkuar me vonë me pjesën tjetër të skuadrës, pasi të dielën në mbrëmje ai ishte në fushë me Napoli në kampionatin italian. Pas seancës të paradites që e zhvilloi i veçant, Hysaj është stërvitur normalisht në seancën e dytë të së mërkurës. Edhe Kristian Panuçi ka shtuar tonet e ngarkesës, teksa në fokus të teknikut ka qenë qarkullimi i topit, një detaj që e ka shumë për zemër në objektivin e tij për ta bërë më sulmuese skuadrën ashtu si në ndeshjet e tij të para në pankinën kuqezi.

SITUATA

Tronditet Milani, falimenton kompania e presidentit Li

Në fushën e lojës Milani po ecën me ritëm Cham pions, por në jashtë saj situata nuk është aspak e mirë. Në fakt, në zyrat e klubit ka mbërritur lajmi që të gjithë i druhenin dhe që trondit nga themelet besueshmërinë e pronarëve kinezë. Kompania kryesore e presidentit Yonghong Li, "Jie Ande" me seli në Kinë ka falimentuar. Kjo kompani konsiderohej si "kasaforta" që i jepte siguri financiare Milanit edhe më parë i rrethuar nga shumë dyshime në lidhje me të ardhurat e padronëve të rinj që morën pronësinë nga Silvio Berlusconi. Por sipas mediave italiane, falimenti i kompanisë më të madhe të presidentit Li nuk do të ketë një efekt të menjëhershëm në klub dhe skuadër, madje mund të mos ndjehet fare duke llogaritur hapat që po ndjek fondi amerikan "Eliot", garantit financiar edhe gjatë ndryshimit të pronësisë. Në fakt, ky fond do të paguajë edhe 35 milionë euro të tjera që do të shërbejnë si garanci deri në fund të këtij sezoni. Ndërkohë gjatë kësaj kohe po punohet edhe për shitjen e klubit. Emri i madh i Milanit ndez shumë interes dhe deri tani janë afruar blerës potencialë si emiri arab Al-Falasi, multi miliarderi Alisher Usmanov dhe një tjetër fond prestigjioz amerikan, emri i të cilit ende nuk bëhet i ditur, por që sipas mediave lokale ka lidhje të ngushtë me industrinë e naftës.



Kupa e Shqipërisë, gjysmëfinalet

Shorti: Skënderbeu gjen Flamurtarin, Kukësi përballë Laçit




KUPA E SHQIPËRISË
GJYSMËFINALET
15-18 PRILL
Skënderbeu-Flamurtari
Laçi-Kukësi

grupin e plotë pasi ajo është mënyra e vetme për të ndaluar skuadrën më në formë të futbollit shqiptar. Çifti tjetër gjysmë-finalist që rezervoi shorti është Laçi-Kukësi. Aktualisht dy ekipet mbajnë vendin e dytë dhe të tretë në renditje, çka përthehet me një vend në Europa Ligë, por asgjë nuk është e sigurt pasi

ngjeshja me ekipet e tjera është shumë e madhe. Kjo përballje ndërmjet Laçit dhe Kukësit në këtë pikë të sezonit hap skenarë të rinj për sa i përket garës europiane. Takimet e para për gjysmëfinalen e Kupës së Shqipërisë do të zhvillohen me 5 prill ndërsa ndeshjet e kthimit më 18 prill.

Katër ekupe, Skënderbeu, Flamurtari, Kukësi dhe Laçi mësuan të mërkurën fatin që i rezervoi shorti i Kupës së Shqipërisë për fazën gjysmë-finale. Goglat risollën dhe një herë për publikun një nga përballjet më të nxehta vitet e fundit, Skënderbeu-Flamurtari. Pavarësisht dominimit total në kampionat, korçarët nuk kanë bërë kurrë dopjetë, Kupa është një trofe që i mungon në CV-në e tyre, ky është sezoni ideal për t'i shkuar deri në fund këtij kompeticioni. Për Flamurtarin kjo është kthyer sfida më e rëndësishme e sezonit pasi nga kampionati nuk e kanë më të sigurt prezencën në Kupat e Evropës. Trajneri Shpëtim Duro shpreson shumë të rikuperojë pjesët të luaj kundër Skënderbeut me

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Steiger aktor.
- Mbetet në fund.
- Ustinov i kinemasë.
- Janë në modë.
- Nuk e shqyen Danielin.
- Një as i Milan.
- Çobani aktore e jona.
- I dyti në kapitull.
- Dy asa në dorë.
- Qe njeriu i parë që u dënuua padrejtësisht.
- Croft e Angelina Jolie.
- Një që mbahet për mondan.
- Para De Janeiro-s.
- Gjysmë tandem.
- Kap ndryshe.
- Gjysmë tatimi a
- Union Stundetor Operativ.
- Wallach aktor.
- Pak spjuanzh.
- Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.

- Ai dhe ajo.
- Një Madame e Maupassant.
- Kështu thirrej Ernesto Guevara.
- Fund ditari.
- Pije piratesh.
- Kush e thotë refuzon.
- Të parat në sondazh.
- Një makinë franceze.
- Fillojnë stafetën.
- Nisin nga fillimi.
- Qan te Turandot.
- Fundi i një samurai.
- Umberto që shkroi Lavjeresi i Foucault.
- Dalë në krye.

VERTIKAL

- Ajo e tretë u quajt Moskë.
- Në hyrje të odës.
- Me mea për të penduarin.
- Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshima.
- Jepet për hartim.
- Lindi edhe Cerberin.
- Mbyllin pora.
- Gjysma e ekipit.
- Një inkursion me mig.
- Fillojnë lehtë.
- Është tretës me zorrë.
- Pak tematike.
- Qe mbreti jetëgjatë i Pilos.
- Është ndalim me pranga.
- Shkroi Këngëtarja tullace.
- Është pikë vaji.
- Ndajnë shtetet.
- Kush nuk ka... s'është njoftuar.
- Poetja e Lesbos.
- Kështu shprehet komisar Rex.
- Fillojnë panikun.
- Një liqen i kripur.
- Inva soprano.
- Iniciale e Altman.
- Një fjalë për sipër.
- Të parat në stadium.
- Fillojnë turnin.
- Në hyrje të sokakut.
- Fillojnë nazet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Një pune... paguhet.
- Para Zeppelin në grupin e famshëm.
- Vincenzo, bomber te Roma.
- Kufijtë e pritjes.
- Një Arthur i Edgar Allan Poe.
- Demek s'ka kufij.
- Qe filozofi i shkollës eleatike.
- Nino, kompozitor i famshëm italian.
- Është ai që ka ngritur krye.
- Finlanda... finlandezëve.
- Mbledh basketë separatistë.
- Iniciale e Prost.
- Shkroi Cocktail party.
- Titulli i Alex ferguson.
- Stile pa kufij.
- Ishin greket që nuk vinin kurrë.
- Unë dhe ti.

VERTIKAL


- Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.
- Në krye të solistëve.
- Janë poetë si Ungaretti.
- Ylli më i shndritshëm i Demit.
- Janë kopjet si dëlja Dolly.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Fillojnë muzikën.
- Parafajla e prejardhjes.
- Fernando, bomber i Liverpool.
- Bisha aktore.
- Ishin ushtarë të Kserksit.
- Partia Demokratike.
- Cepat e një ylli.
- Ylli i baletit.
- Pak amoralitet.
- Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
- Italia në Internet.
- Përhapet me frikë.
- Mund të jetë françeskan.
- Dahin pa kufij.
- Është tända për... raftë.
- Gjysmë sahat.
- Tatum që qe pianist.
- Lloj papagalli.
- Një pikë vaji.
- Artikull spanjoll.
- Në krye të socialistëve.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

3		7	1		6	8
	2			6	1	
6			8	4	9	
2	8		5		3	
	4	2		9	5	
	9		4		7	6
2	1	9				3
7		4			8	
5	8		7	2		9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

4	3	7	9	5	1	8	2	6
1	5	6	8	2	4	3	7	9
2	8	9	3	7	6	4	1	5
9	4	3	6	8	7	1	5	2
8	6	2	1	9	5	7	3	4
7	1	5	2	4	3	6	9	8
5	2	1	4	3	8	9	6	7
3	7	8	5	6	9	2	4	1
6	9	4	7	1	2	5	8	3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- Miku më i madh i së vërtetës është koha, më i madhi armik i saj është paragjykimi, ndërsa shoqërujesja e përhershme është përlulësia.
- Fol vetëm atëherë, kur ajo çfarë ke për të thënë është më e bukur se heshtja...
- Dora e butë thyen edhe gurin më të fortë. Fjala e ëmbël zbut dhe zemrën më të egër...
- Për të pasur sukses, dëshira jote për sukses duhet të jetë më e madhe se frika nga dështimi...

Bill Cosby

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	E	P	O	I	S		10	8	13
4	5	3	5		19	2	4	6	2
5	13	6		3	5	11	6	7	3
11	5		12	2	8	6	3	20	13
9		10	6	20	4	2		4	5
5	2		13	13	2	12	2		3
	12	13	10	2	3	5		6	11
2	7		5	1		3	3	12	8
19		2	4	3	6		6	4	2
2	13	3		5	10	6	13	2	9
4	1	8	5	3		12	5	11	9
6	11	2	7		8	2		6	11

M	I	K	E	K	M	S	E
E	K	A		R	O	M	A
K	M	I	L	I	T	A	N
P	A	S	A	N	I	K	T
E	K	U	A	N	E	T	A
R	E	T	E	E	I	R	A
I	T	R	B	L	A	K	E
M	I	A	R	E	D	E	K
E		M	E	T	A	L	E
T	E	K	E		M	K	U
M	O	R	A	V	I	A	M

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

AR K A A S T R O A M A
D I A N A H A N T I K
A T I L A N T I K E A T L E
P E I T A R I F A T L E
T T P O L I T I K A N E T
K E N E T A O R A R
P A U L I N R R I D I M
A K E O T A A D I E R A
R U M U N E K N I E R A
E T I T E R T A M A N
T E I I G O R A N E
I N T A R O M A D I T I T

FJALËKRYQI (2)

P A B M E L E R G O
R K U P A E M I R A T E
O H A R A D A R O M A T
C I K L I S T E T
S T A D I U M E T A P E L E
D I K A S T E R E R U L E
K E N T N G O P J E V
K A T I A S I E S E
A R N I O L A I R
M A S I M O Z A N O R E
A M A N A N N A N N
T T E R R E N T E I N E



Thënie të mençura

- Çdo herë mbani mend se vendimi juaj për të patur sukses është më i rëndësishëm se çdo gjë tjetër.
- Mos u mundto të behesh njeri i suksesshem por me mire të behesh i vlefshem.
- Askush nuk mund të kthehet prapa dhe të ketë një fillim të ri, por çdokush mund të fillojë sot dhe të ketë një fund të ri...
- Fëmijët kurrë nuk kanë qenë të zotë të dëgjojnë të rriturit, por kurrë nuk kanë dështuar ti imitojnë ata...

Abraham Lincoln (1809 - 1865)
Albert Einstein (1879 - 1955)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

